

Prof. SEJJID KUTUB

**SURETU JÂSÎN**  
KAPTINA JÂSÎN  
PËRKTHIM DHE KOMENTIM

Shkup  
1415/1994

Titulli i origjinalit:

Prof. Sejjid Kutub  
*Fi Dhillalil Kur'an - Sûretu Jâsîn*

Botuar nga:  
Darush - Sharki, 1985  
Bejrut - Kajro

Përktheu:  
**Muhamed Mustafa**

Spored Misleweto na Ministerstvoto za kultura broj 21-801/2 od 09.02.94 godina, za **Pod senkata na Kur'anot - komentar na poglavjeto Jasin**, se pla}a povlastena dano~na stapka.

Sipas mendimit të Ministrisë për Kulturë Nr. 21-801/2 të datës 09.02.94, për **Nën hijen e Kur'anit - sureja Jasin**, bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.

*Prof. Sejjid Kutub*

*Fi Dhillali Kur'an - Nën hijen e Kur'anit*

# Jâ-sîni

Lektor: Fatmire Ajdini

Korrektor: Liljana Jajaga - Meshiq

CIP - Katalogizacija vo publikacija  
Narodna i univerzitetska biblioteka „Kliment Ohridski“ Skopje

297. 18(082. 24)


**KUTUB, Sejjid**


Fi dhilalil Kur'an : sûretu Jâsîn : [përkthim dhe komentim] / Sejjid Kutub ; [përktheu Muhammed Mustafa] - Shkup : Logos -A, 1415/1994 - 120 str. 16 sm

Prevod na deloto: Fi dhilalil Kur'an


a) Jasin


















## **PËRKTHIMI DHE KOMENTIMI I KAPTINËS JÂSÎN \***

### ***PËRKTHIMI I AJETEVE 1-29***

*Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit,  
Mëshirëplotit*

- 1. *Ja, Sinë!***
- 2. *Pasha Kur'anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë!***
- 3. *S'ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve!***
- 4. *Je në një rrugë të drejtë.***
- 5. *(Kur'ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit.***

---

\* Përkthimi i ajeteve të Kur'anit Famëlartë është marrë nga përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit, botuar në Prishtinë më 1988.

6. *Për t'ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar.*
7. *Për Zotin tashmë ka marrë fund vendimi (thënia) kundër shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë.*
8. *Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart.*
9. *Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin.*
10. *Dhe për ata është e njëjtë, a ua tërhoqë vërejtjen a nuk ua tërhoqë, ata nuk besojnë.*
11. *Ti i'a tërheq vërejtjen vetëm atij që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (i papashëm prej njerëzve), pra jepi myzhde atij për falje dhe shpërblim të mirë.*
12. *Vërtet, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat; gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi - Mahfudh).*
13. *Përmendju atyre një shembull të banorëve të fshatit, kur atyre u patën ardhur të dërguarit.*

14. Kur Ne dërguam te ata dy, e ata i përgënjeshtroan që të dy, atëherë i përforcuam me një të tretë dhe u thanë: “Ne jemi të dërguar te ju”.
15. Ata (fshatarët) thanë: “Ju nuk jeni tjetër vetëm se njerëz si ne dhe All-llahu nuk ju ka shpallur asgjë; ju nuk jeni tjetër vetëm se rrenacakë.”
16. Ata thanë: “Zoti ynë e di se me të vërtetë ne jemi të dërguar te ju.
17. Dhe nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t’ju kumtojmë a shtu qartë.”
18. Ata (fshatarët) thanë: “Ne parandjejmë kob me ju dhe nëse nuk tërhiqeni, ne do t’ju gurëzojmë dhe do të përjetoni ndëshkim të idhët prej nesh.”
19. Ata (të dërguarit) thanë: “Fati i keq është juaji, edhe pse u këshilluat (e na kërcënoheni)? Jo, por ju jeni popull i shfrenuar!”
20. Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri që ngutej e tha: “O populli im, dëgjoni të dërguarit!
21. Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes!
22. E ç’kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e te Ai kthehem.

23. *A do të pranoj zota të tjerë pos Tij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë.*
24. *Unë atëherë do të jem në një humbje të hapët.*
25. *Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni!”*
26. *Atij i është thënë: “Hyn në xhennet”, e ai tha: “Ah, sikur ta dinte populli im.*
27. *për çka më fali Zoti im dhe më bëri prej të nderuarve!”*
28. *Pas tij, Ne nuk zbritëm ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tij, e as që ishte vendimi ynë të zbresim tjetër,*
29. *përveç një britme të tmerrshme, kur qe, ata të ftohur (të vdekur).*

## **KOMENTIMI I AJETEVE 1-29**

Kjo sure mekkase ka takte të shkurtra dhe ritme të shpejta. Numri i ajeteve të saj është tetëdhjetë e tre si dhe është më e vogël dhe më e shkurtë se sureja paraprake (surja Fatir), e cila ka dyzet e pesë ajete.

Kështu, tekstet e shkurtra dhe ritmi i shpejtë i japin sures një natyrë të posaçme sepse ritmet vazhdojnë në mënyrë të ndarë dhe tingëllojnë në ndjenja me tingëltime të vazhdueshme. Format dhe pasqyrimet që u përshkruhen skenave të njëpasnjëshme prej fillimit të sures e deri në fund të saj shtojnë edhe më tepër ndikimin e saj sepse janë të llojllojshme, inspiruese dhe me gjurmë të thella.

Temat kryesore të sures janë me tematikë mekkase, ndërsa qëllimi kryesor është ndërtimi i parimeve të besimit, gjë që përputhet me natyrën e shpalljes dhe sinqeritetin e mesazhit që prej fillimit të saj:

*“Ja, Sinë! Pasha Kur’anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë. S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të*

*dërguarve! Je në një rrugë të drejtë. (Kur'ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit..."*

Pastaj vijon tregimi i banorëve të fshatit për të tërhequr vërejtjen nga dënimi për përgënjeshttrimin e shpalljes dhe mesazhit. Pasqyrimi i këtij dënimi bëhet nëpërmjet tregimit për shkak se metoda e Kur'anit mbështetet në tregime për përforcimin e çështjeve të veta.

Dhe për afërsisht nga fundi, sureja përsëri i kthehet të njëjtës temë: *"Ne as nuk ia mësuam atij (Muhammedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë, për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë (me mend e me zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët".*

Gjithashtu në këtë sure theksohet çështja e hyjnisë dhe monoteizmit sepse idhujtaria mohohet me gjuhën e njeriut besimtar, i cili erdhi prej skajit më të largët të qytetit për ta bindur popullin për çështjen e të dërguarve edhe ate duke thënë: *"E ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi dhe te Ai kthehem?! A do të pranoj zota të tjerë pos Tij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë. Unë atëherë do të jem në një humbje të hapët."*

Nga fundi i sures ripërsëritet edhe një herë kjo temë: *“Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre. Ata nuk mund t’u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme e tyre”.*

Kjo sure përqëndrohet edhe në çështjen e ringjalljes dhe rilindjes e cila përsëritet në shumë vende të kësaj sureje. Në fillim thuhet: *“Vërtet, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat, gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi - Mahfudh).”* Pastaj vjen në radhë tregimi i banorëve të fshatit për atë që i ka ndodhur besimtarit. Shpërblimi i shpejtë i tij ishte: *“Atij i është thënë: ‘Hyn në xhennet!’, e ai tha: ‘Ah, sikur ta dinte populli im për çka më fali Zoti im dhe më bëri prej të nderuarve!’”*

Në mes të sures thuhet kështu: *“Dhe thoshin: ‘Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?’ (All-llahu u përgjigjet) Nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete. E nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet testament), as të kthehen te familjet e tyre”.* Kurse në fund të sures, kjo çështje theksohet në mënyrë dialogu: *“Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: ‘Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?’ Th uajji: ‘I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim’.”*

Kjo çështje, që ka të bëjë me besimin dhe parimet e tij, përsëritet në suret mekkase edhe atë çdoherë nga një kënd i posaçëm dhe nga një ngjarje e posaçme si dhe përmban udhëzime që përputhen me atmosferën dhe harmonizohen me ritmin, pasqyrimin dhe format e saj.

Këto udhëzime në këtë sure (posaçërisht) janë të nxjerrura nga skenat e kijametit dhe nga skenat e tregimit, qëndrimet dhe dialogut të tij si dhe nga shkatërrimet e paraardhësve gjatë historisë, pastaj nga skenat e shumta të llojlojshme dhe inspiruese kozmologjike: skena e tokës së vdekur ku lindë jeta, skena e natës së errët prej së cilës agon dita, skena e diellit që udhëton drejt kufirit të vet (në cakun përfundimtar), skena e hënës që kalon nëpër fazat e veta derisa të kthehet në trajtën e harkut, skena e pasardhësve të Ademit që barten në anije të mbushura përplot, skena e kafshëve që u shërbejnë njerëzve, skena e pikës së ujit (farës) dhe njeriut që është kundërshtar i rreptë dhe skena e drurit të gjelbër, në të cilin gjendet zjarri që e ndezin!

Përpos këtyre udhëzimeve ekzistojnë edhe udhëzime tjera që kanë të bëjnë me intuitën e njeriut dhe ngjalljen e tij: pasqyrimi i përgënjeshtarëve, për të cilët ka marrë fund vendimi i Zotit mbi kufrin e tyre, aq sa edhe ajetet dhe tërheqjet e vërejtjeve nuk mund të ndikojnë: “Ne u

*kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart. Ne kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin".* Pastaj pasqyrimi i shpirtrave të tyre, si në formën e fshehtë ashtu edhe në ate publike, të cilat i di Zoti dhe nuk mund të mbulohen; pasqyrimi i mjetit të krijimit dhe atë vetëm me fjalë: *"Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: "Bëhu!" Ai menjëherë bëhet".*

Të gjitha këto udhëzime ndikojnë në zemrën e njeriut dhe ai mund të bindet në autenticitetin e tyre në realitetin objektiv.

\* \* \*

Në kontekstin e kësaj sure, tema pasqyrohet në tri pjesë.

1. Pjesa e parë fillon me betimin në dy shkronjat *"Ja, Sinë"* dhe në Kur'anin e urtë për vërtetimin e mesazhit të Pejgamberit a.s. dhe se ai është në rrugë të drejtë. Pastaj vijon zbulimi i fundit të kobshëm për përgënjeshtarët, që është vendim i Zotit, gjegjësisht të mos e gjejnë rrugën e udhëzimit njëherë e përgjithmonë. Tërheqja e vërejtjes ndikon në atë që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (i padukshëm për njerëzit). Pastaj e udhëzon të Dërguarin t'ua jep

shembullin e banorëve të fshatit dhe t'ua rrëfejë tregimin e përgënjeshtimit dhe dënimin e përgënjeshtarëve. Gjithashtu paraqitet natyra e besimit në zemrën e besimtarit dhe shpërblimi i imanit dhe i dëshmisë.

Pastaj fillon pjesa e dytë me theksimin e fatkeqësisë për robtë, të cilët përgënjeshtrojnë çdo pejgamber dhe tallen me ta, nuk marrin mësim nga shkatërrimet e përgënjeshtarëve e as që i vërejnë me vëmendje shenjat e All-llahut në gjithësi, të cilat janë të shumta... Këtu theksohen ato skena kozmologjike të cilat u përmendën në fillim të sures. Këtu gjithashtu theksohen edhe skenat e kijametit me detajzime të shumta.

Në pjesën e tretë rezymohen të gjitha temat e sures. Në fillim mohohet se ajo që i është shpallur Muhammedit a.s. është poezi si dhe kategorikisht mohohet relacioni i të Dërguarit me poezinë. Pastaj pasqyrohen disa skena dhe fakte që vërtetojnë Hyjninë Absolute si dhe qortohen ata të cilët u luten zotave tjerë përveç All-llahut dhe prej tyre kërkojnë ndihmë kurse në anën tjetër vetë ata (njerëzit) i mbrojnë zotat! Aty theksohet çështja e ringjalljes dhe rilindjes, u rikujtohet krijimi i parë prej spermës që të shohin se ringjallja e eshtrave të kalbur i ngjanë krijimit të parë dhe se aty s'ka gjë të parëndomtë! U rikujtohet druri i gjelbërt i cili ka në

vete zjarr edhe pse kanë dallim të madh njëri prej tjetrit.

Krijimi i qiejve dhe i tokës konfirmon fuqinë për krijimin e njerëzve si në këtë botë (dynja) ashtu edhe në botën tjetër (ahiret).

Dhe në fund, vijon ajeti i fundit i sures:

*“Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t’i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet. I lartë është Ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm te Ai kthehemi.”*

Tash, pas këtij pasqyrimi të përgjithshëm, të fillojmë në detaje!

\* \* \*

*“Ja, Sinë! Pasha Kur’anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë! S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve. Je në një rrugë të drejtë. (Kur’ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit, për t’ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar. Për Zotin tashmë ka marrë fund vendimi (thënia) kundër shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë. Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart. Ne kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin. Dhe për ata është e njëjtë, a ua tërhoqe vërejtjen a nuk ua*

*tërhoqe, ata nuk besojnë. Ti ia tërheq vërejtjen vetëm atij që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (i papashëm prej njerëzve), pra jepi myzhde atij për falje dhe shpërblim të mirë. Vërtet, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat; gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi - Mahvudh)”.*

Zoti i Madhëruar betohet në këto dy shkronja: “Ja, Sinë”, të ndara dhe Kur'anin e urtë. Bashkimi mes shkronjave të ndara dhe Kur'anit arsyeton mënyrën që e zgjodhëm për komentimin e këtyre shkronjave në fillim të sureve dhe relacionin mes theksimit të tyre dhe theksimit të Kur'anit. Ajeti është nga Zoti dhe se Kur'ani i rikthen ata të cilët nuk përsiasin në këtë ajet, pastaj ai përbëhet prej llojit të këtyre shkronjave mirëpo radhitja intelektuale dhe ekspresive është mbi formën e këtyre shkronjave.

E përshkruajnë Kur'anin (gjithashtu edhe betohen në të) si “*Kur'an i urtë*” ndërsa urtësia është cilësi e njeriut të mençur. Kështu, ekspresiviteti i llojit të tillë i dhuron Kur'anit cilësitë e jetës, qëllimit dhe dëshirës, të cilat i takojnë të urtit.

Edhe pse kjo është alegori, përsëri pasqyron një të vërtetë dhe e ofron atë.

Me të vërtetë ky Kur'an ka shpirt!

Ai i ka cilësitë e të gjallit, i cili të shpreh dhembshuri dhe ti i shpreh atij dhembshuri kur ia hap zemrën dhe shpirtin!

Sa më shumë që ia hap zemrën dhe sa më i sinqertë të jesh ndaj tij, aq më shumë do të thellohesh në fshehtësitë e tij! Mahnitesh prej karakteristikave dhe fizionomisë së tij ashtu siç mahnitesh prej karakteristikave dhe fizionomisë së shokut kur e shoqëron një kohë, ndien qetësi dhe çlodhesh nën hijen e tij!

I Dërguari i Zotit dëshironte të dëgjojë leximin e Kur'anit nga të tjerët dhe ndalej para dyerve ku lexohej Kur'ani dhe e dëgjonte ashtu siç e dëgjon shoku i sinqertë biografinë e shokut të sinqertë!

Kur'ani është i urtë, i drejtohet secilit sipas intelektit të tij, ndikon në pjesën e ndieshme të zemrës; i flet (njeriut) me ndikim të shëndoshë dhe me urtësi që përmirëson e udhëzon.

Kur'ani është i urtë dhe edukon me urtësi sipas metodës së drejtë racionale dhe psikike, metodës që i përfshinë të gjitha fuqitë e njerëzve dhe i udhëzon në mënyrë të drejtë e të shëndoshë; i cakton jetës rregullim dhe gjithashtu i lejon të gjitha aktivitetet njerëzore brenda suazave të kësaj metode të urtë.

Zoti i Madhëruar betohet në shkronjat “Ja, Sinë” dhe në Kur’anin e urtë për të vërtetën e shpalljes dhe mesazhit të të Dërguarit fisnik a.s.: *“S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve. Je në një rrugë të drejtë”*.

I Lartmadhëruari s’ka nevojë për betim por betimi i Tij në Kur’an dhe në shkronjat e tij i dhuron betuesit madhësinë dhe shkëlqesinë sepse Zoti i Madhëruar betohet vetëm në një gjë të madhe e cila meriton betim!

*“S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve...”*

Pohimi i tillë inspiron se dërgimi i të dërguarve është çështje e vendosur me përparësi definitive.

Këtu nuk dëshirohet vërtetimi i këtij fakti, por dëshirohet të vërtetohet se Muhammedi a.s. është prej atyre të dërguarve; i drejtohet atij (Muhammedit a.s.) me këtë betim pa e udhëzuar t’u drejtohet mohuesve përgënjeshtarë për shkak se vlera e betimit, peygamberit dhe mesazhit s’mund të jetë diskutabile nga se lajmi të Dërguarit i vjen drejt nga Zoti xh.sh.

*“S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve. Je në një rrugë të drejtë.”*

Këtu paraqitet natyra e mesazhit pas paraqitjes të të vërtetës së peygamberit. Natyra e këtij mesazhi

është rruga e drejtë si tehu i shpatës pa kurrfarë lakesh, devijimesh, animesh apo shtrembërimesh. E vërteta në te është e qartë dhe pa kurrfarë ngatërresash e përzierjesh, nuk anon kah epshi e as kah interesi. Kërkuesi e gjenë me lehtësi, saktësi dhe sinqeritet.

Për shkak të drejtësisë së tij (mesazhit), aty nuk ka tollovi e as shmangje e as që paraqiten probleme të koncepteve dhe formave dialektike. Ky mesazh e pasqyron të vërtetën edhe në formën më të imët të saj, e pastron nga shtrembërimet dhe kaosi si dhe e bën të kalojë pa eksplikim.

Ndarja e teksteve, krijimi i termave, kuptimet dhe nocionet e thella janë gjithashtu karakteristika të mesazhit.

Me te mund të jetojë fshatari dhe qytetari, i padituri dhe i dituri, ai që jeton në kasollë dhe ai që jeton në pallat; në te e gjen çdokush atë që e kërkon dhe e përfiton me lehtësim atë që ia drejton jetën, disiplinën dhe relacionet...

Mesazhi përputhet me esencën e gjithësisë dhe ekzistencës, me natyrën e gjërave dhe gjallesave që gjenden rreth njeriut, nuk konfrontohet me karakteret e gjërave e as që e obligon njeriun të konfrontohet me to. Ai është i drejtë në metodë, në harmoni dhe në bashkëpunim me rregullat tjera, të cilat

mbizotërojnë në botën e ekzistencës dhe ekzistencave.

Pastaj ai është rrugë e drejtë në drejtim të Zotit xh.sh. të udhëzon te Ai, nuk frikohet përcjellësi i kësaj rruge se mos po humbë nga Krijuesi i tij e as të devijojë. Kështu, ai ecë në rrugë të drejtë që përfundon me pëlqimin e Krijuesit të Madhëruar.

Kur'ani është udhërrëfyes i kësaj rruge të drejtë dhe kudo që udhëton njeriu (i shoqëruar) me të, do ta gjejë të drejtën në paraqitjen e tij të së vërtetës, në udhëzim e në parimet e përcaktuara mbi vlerat dhe në vënien e saktë të çdo vlere në vendin e duhur.

*“(Kur’ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit”.*

Vetë Zoti i njofton robërit e Vet në vende të tilla për të kuptuar të vërtetën e asaj që ua ka shpallur. Ai është i Plotfuqishëm dhe Mëshirues, vepron sipas dëshirës së Vet, është Mëshirues ndaj robërve të Vet dhe i obligon me qëllim mëshire.

Paralajmërimi dhe informimi paraqesin urtësinë e “Zbritjes”:

*“Për t’ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar”.*

Neglijenca më së shumti i prishë zemrat sepse zemra e pakujdesshme (dhe e humbur) nuk funksionon, nuk pranon, nuk ndikohet dhe nuk përgjigjet, kalojnë rreth saj argumentet e udhëzimit ose ajo kalon rreth tyre pa i ndier dhe pa i parë, pa pulsime ose pa pranim. Pastaj, paralajmërimi më së shumti i përgjigjet neglijencës që e përjetonte populli, i cili jetoi gjenerata pa e paralajmëruar ndokush ose t'ia tërheqë vërejtjen. Ky popull ishte pasardhës i Ismailit pas të cilit nuk kishte ardhur ndonjë pejgamber. Paralajmërimi mund t'i zgjojë mospërfillësit dhe të gjumosurit, të cilëve nuk u ka ardhur paralajmëruar, as atyre e as të parëve të tyre.

Pastaj zbulon fatin e tyre mospërfillës dhe atë që u shpall nga Zoti xh.sh. me fuqinë e Tij, ashtu siç i njohu Zoti zemrat dhe çështjet e tyre, të kaluarën e të ardhmen:

*“Për Zotin tashmë ka marrë fund vendimi (thënia) kundër shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë”.*

Çështja e tyre është vendosur dhe vendimi i Zotit xh.sh. kundër shumicës së tyre ka marrë fund në bazë të njohjes të të vërtetës mbi ta dhe mbi natyrën e ndjenjave të tyre. Ata nuk besojnë. Ky është fundi i shumicës. Shpirtrat e tyre janë të

mbuluar nga udhëzimi, andaj ata nuk i shohin argumentet ose nuk i ndjejnë.

Këtu pasqyrohet një skenë materiale e gjendjes së tillë psikike, pasqyrohen të lidhur me pranga që s'mund të shihen, sytë e tyre janë të mbuluara dhe pengesat e ngatërresat qëndrojnë mes tyre dhe mes udhëzimit e besimit (imani).

*“Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart. Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin”.*

Duart e tyre janë të lidhura me pranga deri në qafat e tyre, gjegjësisht deri në nofulla, kurse kokat e tyre janë të ngritura lart dhe s'mund të shohin përpara.

Pasi që janë në këtë pozitë të vështirë, ata nuk kanë shikim e pamje të lirë! Kështu, me pendë para dhe me pendë prapa është e pamundur të takohen me udhëzimin dhe sikur të mënjanohej pengesa e të shikonin, përsëri sytë e tyre nuk do të shihnin për shkak të këtyre pengesave!

Rruga e shikimit të tyre është e mbyllur kurse sytë janë të errësuar!

Edhe pse kjo skenë materiale është e vështirë, njeriu takohet me njerëz të këtij lloji, jeton në iluzion kurse ata nuk e shohin të vërtetën e qartë dhe nuk

kuptojnë se ka pengesë të madhe; sikur të mos ishin këto pranga në duart e tyre, sikur të mos ishin kokat e tyre të ngritura lart; (vërejmë) se shpirtrat dhe sytë e tyre janë larg udhëzimit dhe të vërtetës sepse mes tyre dhe mes argumenteve të udhëzimit ekzistojnë pengesa. Ata të cilët e kundërshtojnë këtë Kur'an i ngjajnë mohimit dhe refuzimit të tyre.

Kur'ani mbështetet në argumente e fakte bile edhe vetë është argument të cilit s'mund t'i kundërvihet asnjë njeri!

*“Dhe për ata është e njëjtë, a ua tërhoqe vërejtjen a nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë.”*

Vendimi i Zotit xh.sh. për ta ka marrë fund edhe ate duke u bazuar në njohjen e natyrës së zemrave të tyre, në të cilat nuk depërton imani (besimi); nuk ndikon tërheqja e vërejtjes në zemrën që nuk e pranon besimin e që mes saj dhe besimit ka penda.

Tërheqja e vërejtjes nuk krijon zemra por e zgjon zemrën e gjallë e të përgatitur për mësim:

*“Ti ia tërheq vërejtjen vetëm atij që e përvetëson Kur'anin (dhikrin) dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (i papashëm prej njerëzve), pra jepi myzhde atij për falje dhe shpërblim të mirë.”*

“Dhikri” këtu nënkupton Kur'anin (me gjasë).

Ai që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit, ka dobi prej tërheqjes së vërejtjes. Duket se vetëm këtij i është drejtuar tërheqja e vërejtjes, dhe se Pejgamberi a.s. vetëm këtij ia tërheq vërejtjen edhe pse ka karakter të përgjithshëm, mirëpo mes tyre dhe mësimit ka humnerë. Prandaj është përcaktuar vetëm për ate që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm. Vetëm njeriu i tillë meriton shpërblim për shkak të ndikimit pozitiv të tërheqjes së vërejtjes: *“Pra jepi myzhde atij për falje dhe shpërblim të mirë.”*

Falja realizohet në rast gabimi të pavetëdijshëm kurse shpërblimi i mirë në rast të frikës nga Mëshiruesi në vetmi dhe aplikimi i shpalljes së Tij. Këto janë dy gjëra të pandashme në zemër sepse kur depërton frika e Zotit xh.sh. në zemër, vijon praktika sipas shpalljes dhe mënyrës që i dëshiron Ai.

Këtu vërteton aktin e ringjalljes dhe saktësinë e llogarisë që s'harron asgjë:

*“Vërtetë, Ne i ngjallim të vdekurit dhe ua shkruajmë veprat; gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi-Mahfudh)”.*

Ngjallja e të vdekurve është një ndër çështjet të cilat kanë shkaktuar diskutime të shumta. Do të cekim

shembuj të ndryshëm nga ky aspekt në këtë sure. Ai ua tërheq vërejtjen se çdo vepër e tyre dhe çdo gjurmë e veprave të tyre regjistrohet e numërohet pa kaluar e harruar gjë.

All-llahu i Madhëruar i ngjallë të vdekurit, i regjistron veprat e tyre, numëron dhe konfirmon çdo gjë. Pra, e gjithë kjo patjetër të ndodhë ashtu siç i takon fuqisë së Zotit xh.sh.

Komentimi i librit të ruajtur Levhi-Mahfudh dhe çështjeve tjera më së miri kuptohet si dituri e përhershme dhe e amshueshme e All-llahut, i cili di çdo gjë!

\* \* \*

Pas prezentimit të çështjes së shpalljes së mesazhit dhe çështjes së ringjalljes e llogarisë në mënyrë konfirmative, fillon konteksti i prezentimit në mënyrë rrëfyese që ndikon në zemër ngase rrëfen për qëndrimet e përgënjeshtimit dhe besimit si dhe për shpërblimet e dënimit që prezentohen sikur të ishin në formë të dukshme:

*“Përmendju atyre një shembull të banorëve të fshatit, kur atyre u patën ardhur të dërguarit. Kur Ne dërguam te ata dy, e ata i përgënjeshtuan që të dy, atëherë i përforcuam me një të tretë dhe u thanë: 'Ne jemi të dërguar te ju'. Ata (fshatarët) thanë: 'Ju nuk jeni tjetër, vetëm se njerëz sikurse ne dhe All-llahu nuk ju ka*

*shpallur asgjë; ju nuk jeni tjetër vetëm se rrenacakë'. Ata thanë: 'Zoti ynë e di se me të vërtetë ne jemi të dërguar te ju dhe ne nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t'u kumtojmë ashtu qartë'. Ata (fshatarët) thanë: 'Ne parandajmë kob me ju dhe nëse nuk tërhiqeni, ne do t'ju gurëzojmë dhe do të përjetoni ndëshkim të idhët prej nesh'. Ata (të dërguarit) thanë: 'Fati i keq është i juaji, edhe pse u këshilluat (e na kërcënoheni)? Jo, por ju jeni popull i shfrenuar'."*

Në Kur'an nuk është cekur se cilët janë banorët e fshatit, e as për cilin fshat bëhet fjalë. Për këtë ekzistojnë transmetime të llojllojshme të cilat s'ka nevojë t'i cekim këtu.

Mostregimi i emrit në Kur'an është argument se emri apo lokaliteti nuk kanë ndikim të madh në këtë rrëfim. Pas mënjanimit të një përkufizimi të tillë i është qasur thelbit të shembullit. Ky është një fshat, në të cilin Zoti xh.sh. ka dërguar dy peygamberë ashtu siç e dërgoi Musain dhe vëllain e tij Harunin (a.s.) te Faraoni dhe populli i tij. Pasi fshatarët i përgënjeshtroan, Zoti i përforcoi me një peygamber të tretë, i cili konfirmonte se ai së bashku me dy të tjerët janë të dërguar nga Zoti xh.sh. Kështu përsëri filluan thirrjen e tyre e thanë: *"Ne jemi të dërguar te ju."* Mirëpo fshatarët i refuzuan ashtu siç u mohuan edhe të dërguarit dhe mesazhet tjera në histori: *"Ata (fshatarët) thanë: 'Ju nuk jeni tjetër vetëm se njerëz*

*sikurse ne dhe All-llahu nuk ju ka shpallur asgjë, ju nuk jeni tjetër vetëm se rrenacakë'."*

Në refuzimin e përsëritur për shkak të natyrës njerëzore të peygamberëve vërehet naiviteti i përfytyrimit dhe njohjes si dhe mosnjohja e misionit të peygamberit. Gjithmonë kanë pritur të gjejnë ndonjë mister të paqartë në personalitetin dhe jetën e peygamberit, pas të cilit fshehen iluzionet dhe legjendat...

Pasi është peygamber i dërguar nga qielli në tokë, atëherë si mund të jetë pa iluzione e legjenda? Si mund të jetë personalitet i rëndomtë, pa sekrete e enigma?

Si mund të jetë personalitet i rëndomtë njerëzor që u ngjanë personaliteteve të tregjeve dhe shtëpive (njerëzve të rëndomtë)?!

Ky është naiviteti i përkufizimit dhe i mendimit sepse sekretet dhe enigmat nuk janë cilësi të pagamberisë dhe mesazhit, bile jo në këtë formë naive infantile. Aty ka një fshehtësi të madhe mirëpo pasqyrohet në të vërtetën e rëndomtë objektive, e vërtetë që i dhuron ndonjërit prej atyre njerëzve përgatitje nga lartë nëpërmes shpalljes qiellore atëherë kur e zgjedh Zoti xh.sh. për ta transmetuar këtë shpallje të çuditshme. Ky fakt është më i

çuditshëm se të jetë peygamberi engjëll, gjegjësisht ashtu siç sugjeronin!

Mesazhi është metodë hyjnore që e përjeton njerëzimi kurse jeta e peygamberit është shembull real i jetës që zhvillohet sipas kësaj metode hyjnore; jeta e tij është model në të cilin thirret populli. Pasi që populli përbëhet prej njerëzve atëherë patjetër të jetë edhe peygamberi i tyre njeri, me qëllim që të realizojë një jetë që mund të aplikohet.

Pastaj, jeta e Peygamberit a.s. ka qenë gjithmonë para syve të popullit të vet. Kur'ani (Libri autentik i Zotit) i ka regjistruar pikat kryesore të kësaj jete, edhe ate në mënyrë të përimtësuar, duke e përshkruar formën që ishte para syve të popullit me vite e shekuj. Nga këto përimtësime mund të veçojmë jetën e tij shtëpiake dhe private, bile edhe mendimet e tij të brendshme Kur'ani i ka regjistruar disa herë për t'u treguar gjeneratave zemrën e atij peygamberi që ishte njeri.

Përkundrazi, kjo e vërtetë e qartë dhe e afërt u refuzua nga njerëzit! Fshatarët e atij fshati u kanë thënë të tre të dërguarve të tyre: *“Ju nuk jeni tjetër vetëm se njerëz si ne”* (kishin për qëllim atë se ju nuk jeni peygamberë) dhe se *“All-llahu nuk ju ka shpallur gjë”* (nga ajo që predikoni se Zoti ua ka

shpallur); *“ju nuk jeni tjetër vetëm se rrenacakë”* (mendoni se jeni të dërguar).

Pejgamberët u përgjigjën ashtu siç përgjigjet njeriu që është i bindur në sinqeritetin e vet dhe që e njeh misionin e vet:

*“Ata thanë: 'Zoti ynë e di se me të vërtetë ne jemi të dërguar te ju dhe ne nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t'ju kumtojmë ashtu qartë'.”*

Zoti e di dhe kjo mjafton!

Misioni i pejgamberëve është lajmërimi, gjë që edhe e kanë realizuar. Njerëzit pastaj janë të lirë në veprim e në përgjegjësi. Mes njerëzve dhe pejgamberëve gjendet mesazhi nga Zoti xh.sh., e kur të realizohet kjo çështje, atëherë çdo gjë do t'i takojë Zotit.

Përgënjeshtarët e humbur nuk i vërejnë gjërat nga ky prizëm i qartë dhe i lehtë e as që i durojnë udhërrëfyesit, por bëjnë mëkatë dhe përdorin metodën e rreptë dhe të vrazhdë për ta rezistuar argumentin ngase i humburi është zemërngushtë dhe i lig:

*“Ata (fshatarët) thanë: 'Ne parandjejmë kob me ju dhe nëse nuk tërhiqeni, ne do t'ju gurëzojmë dhe do të përjetoni ndëshkim të idhët prej nesh'.”* Ata thanë: 'Ne parandjejmë pesimizëm nga ju dhe kob nga thirrja e

juaj. Po qe se nuk ndaleni, ne nuk do t'ju tolerojmë dhe nuk do t'ju lejojmë ta predikoni thirrjen tuaj.'

Kështu deklaroi i humburi atë që e fshehte në vete, iu kërcënua udhërrëfyesve, kundërshtoi fjalën udhëzuese të së vërtetës dhe i dëshmoi idetë dhe mendimet e liga!

Përkundrazi, detyra e obliguar i detyroi peygamberët të vazhdojnë rrugën: *“Ata (të dërguarit) thanë: 'Fati i keq është i juaj'.”*

Pesimizmi nga ndonjë thirrje ose ndonjë aspekt tjetër është legjendë prej legjendave të xhahilijetit (periudhës së injorancës). Peygamberët u tregojnë popujve të vet se pesimizmi i tillë është besëtytni dhe se fati i tyre i mirë apo i keq nuk vjen nga jashtë por është në shpirtrat e tyre i lidhur me qëllimet dhe veprat e tyre, varësisht nga përfitimi dhe puna. Ata mund ta bëjnë fatin e tyre të mirë apo të keq sepse dëshira e Zotit xh.sh. realizohet nëpërmjet dëshirës së shpirtit, drejtimit dhe punës së tij. Njeriu vetë e përcakton fatin!

Kjo është një e vërtetë që ka parim të shëndoshë, kurse pesimizmi i gjithëllojshëm gjegjësisht pesimizmi nga vendet apo nga fjalët është besëtytni e pakuptuar dhe e palogjikshme! Të dërguarit u thanë: *“Edhe pse u këshilluat (e na kërcënoheni)?”*

A do të na gjuani me gurë e do të na maltretoni për shkak se ju këshillojmë?

A kështu shpërblehet këshillimi?

*“Jo, por ju jeni popull i shfrenuar!”*

I tejkaloni kufijtë e mendimit dhe logjikës së shëndoshë, i kundërveheni këshillës me kërcënim e kanosje dhe e rezistoni thirrjen (islame) me gurë e maltretim!

\* \* \*

Ky ishte reagimi i zemrave të mbyllura kundër thirrjes së pejgamberëve. Kjo sure në periudhën e parë fliste për këtë lloj të zemrave, e cila është formë e realtë e modelit njerëzor që u përshkrua më parë.

Modeli tjetër, i cili e mëvetësoi Kur'anin dhe u frikësua nga Mëshiruesi edhe kur ishte vetëm, ndërmori rrugë tjetër dhe nuk u përgjigj si ai i pari:

*“Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri që ngutej e tha: 'O populli im, dëgjoni të dërguarit! Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes! E ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e te Ai kthehem! A do të pranoj zota të tjerë pos Tij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë. Unë do të jem*

*atëherë në një humbje të hapët. Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni!"*

Kjo është përgjigjja e arsyes së shëndoshë ndaj thirrjes së drejtë të të vërtetës! Në te ka sinqeritet, modesti, energji, drejtësi, perceptim të drejtë dhe plotësim të ritmit të fortë të së vërtetës së ruajtur.

Ky është një njeri që kishte dëgjuar thirrjen dhe i ishte përgjigjur pasi që ishte bindur me argumentet e të vërtetës dhe logjikës. Kur e përjetoj zemra të vërtetën e besimit (imanit) i nxiti ndjenjat e tij aq sa s'mundi të heshtë e ta fshehtë besimin pasi që shihte përreth vetes humbje, refuzim dhe amoralitet. Ai vrapoi pas të vërtetës që u rrënjos në ndjenjat dhe që e zgjoi ndërgjegjen e tij. Ai bëri përpjekje në mesin e popullit të tij që ishte përgënjeshtar, refuzues e kërcënues. Ai erdhi prej skajit më të largët të qytetit me nxitim për ta kryer obligimin e vet e ta thërret popullin në të vërtetën, ta pengojë nga e keqja dhe ta rezistojë armiqësinë e tij të mëkatshme ndaj të dërguarve.

Vërehet qartë se ky njeri nuk kishte autoritet e pozitë, s'kishte ndikim në popull e as përkrahje nga familja por besimi (bindja) i tij energjik që ishte në ndërgjegjen e tij e nxiti të vjen nga skaji më i largët i qytetit:

*“E tha: ‘O populli im, dëgjoni të dërguarit! Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes!’”*

Ai i cili thërret kështu pa kërkuar ndonjë shpërblim apo pasuri, është i sinqertë, sepse në të kundërtën çka do ta ngarkonte me këtë barrë e që s'është obligim nga Zoti! Çka e shtyri t'i qaset kësaj thirrjeje, t'u përballojë njerëzve që nuk e pranonin besimin dhe t'i nënshtrohet dëmit, sherrit, talljes dhe nënçmimit të tyre pa kurrfarë dobie e shpërblimi? *“Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes!”*

Udhërrëfimi i tyre (i pejgamberëve) është i qartë nga natyra e thirrjes së tyre ngase thirrin në Zotin Një, në rrugën e qartë dhe në besimin që është i pastër nga besëtytnitë dhe paqartësitë. Ata udhëzojnë në rrugën e shëndoshë e të drejtë.

Pastaj filloi t'u rrëfej për vetveten, shkaqet e pranimit të besimit dhe për arsyen e tij të zgjuar e cila ishte e bindur me argument të shëndoshë instinktiv:

*“E, ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e te Ai kthehem! A do të pranoj zota të tjerë pos Atij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë. Unë atëherë do të jem në një humbje të hapët”.*

Kjo është çështja e instinktit që e ndien Krijuesin dhe që është i lidhur me burimin e vetëm të qenies së tij... *"E ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi?"* Çka më largon nga kjo metodë natyrore, të cilën e rikujton menjëherë shpirti?

Instinkteti i graviton ai që i ka krijuar, atij i drejtohen dhe nuk devijojnë e as që largohen nga ai përpos nën ndikimin e ndonjë faktori të jashtëm.

Drejtimi kah Krijuesi ka më shumë prioritet dhe është më parësor dhe s'ka nevojë për ndonjë element që është jashtë natyrës së shpirtit dhe orientimit shpirtëror instinktiv.

Besimtari e ndien këtë në vete dhe e shpreh në mënyrë të thjeshtë pa kurrfarë kompleksi, vështirësie dhe bisede të tërthortë!

Ai ndien me instinktin e vet të pastër e të sigurtë se krijesa në fund do t'i kthehet Krijuesit ashtu siç i kthehet çdo gjë bazamentit të vet: *"Dhe Atij i kthehem!"*

Pyete veten se pse të mos e adhuroj Atë që më krijoi dhe Atij që i takon rikthimi? Kështu ai flet për kthimin e sërishëm! Pasi që Ai është Krijues i tyre, atëherë meriton edhe të adhurohet.

Pastaj prezentohet metoda tjetër që është në kundërshtim me metodën e drejtë instinktive sepse është metodë që shpie në humbje: *"A do të pranoj*

*zota të tjerë pos Atij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë”.*

A të humbem nga ai që e braktisë logjikën e instinktit që e thërret krijesën ta adhurojë Krijuesin e vet dhe nga ai që adhuron diçka tjetër përveç Krijuesit, edhe ate pa kurrfarë nevoje e shkak?

A të humbem nga ai që largohet nga Krijuesi dhe i lutë zotat e dobët të cilët s'mund ta mbrojnë nga dëmet kur dëshiron Krijuesi ta ndëshkojë për shkak të devijimit dhe humbjes së tij?

*“Unë atëherë do të jem në një humbje të hapët.”*

Njeriu, i cili fliste me gjuhën e instinktit të singertë, njohës e të qartë, tash vendos përfundimisht që t'i bëjë ballë popullit të tij përgënjeshtar e kërcënues sepse instinkti në zemrën e tij është më i fuqishëm se çdo kërcënim dhe përgënjeshttrim: *“Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni”.*

Kështu, e shprehu fjalën e besimit të plotë e të bindshëm, u deklarua para tyre dhe i inspiroi që ta përsërisin fjalën e tij sepse ai nuk mërzitej nga thashethënat e tyre.

\* \* \*

Konteksti i tregimit na e bënë të ditur se e kanë vrarë edhe pse një gjë e tillë nuk theksohet në

mënyrë direkte. E mbulon botën me gjithë çka ka dhe popullin me gjitha veprat e tij e pastaj e ngrë atë për ta parë këtë shehid (martir) i cili deklaroi fjalën e të vërtetës dhe i sulmoi fytyrat e kërcënuesve edhe ate duke u mbështetur në zërin e instinktit.

E gjejmë atë në botën tjetër (ahiret) dhe shohim se çfarë respekti i ka treguar Zoti xh.sh., gjegjësisht respektin që e meriton besimtari trim, i sinqertë dhe shehid (martir):

*“Atij i është thënë: 'Hyn në xhennet!', e ai tha: 'Ah, sikur ta dinte populli im për çka më fali Zoti im dhe më bëri prej të nderuarve'.”*

Bashkangjitet jeta e kësaj bote (dynjasë) me atë të botës tjetër (ahiretit) kurse vdekjen e shohim si transferim prej botës së kaluar në atë të amshueshme, si hap që e shpëton besimtarin prej tokës së ngushtë në parajsën (xhennetin) e gjerë, prej humbjes në qetësinë e të vërtetës, prej kërcënimit të amoralit në paqen e xhennetit dhe prej errësirës së xhahillijetit në dritën e vërtetë.

Vërejmë se besimtari e ka parë mëshirën dhe respektin, që ia ka përgatitur Zoti xh.sh. në xhennet, e këshillon popullin e vet me zemër të mirë dhe shpirt të kënaqur si dhe dëshiron populli i tij të sheh respektin dhe kënaqësinë e përfituar, me qëllim që ta njohë të vërtetën me njohje të vërtetë.

\* \* \*

Ky ishte shpërblimi i besimit (imanit)! Për Zotin xh.sh. është më lehtë të dërgojë engjëj e ta shkatërrojë të ligën sepse ajo është shumë e dobët: *“Pas tij, Ne nuk zbritëm ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tij, e as që ishte vendimi ynë të zbresim tjetër, përveç një britme të tmerrshme, kur qe, ata të ftohur (të vdekur)”*.

Këtu nuk e zgjatë përshkrimin e fundit të kobshëm të popullit për shkak të nënçmimit dhe poshtërimit të tyre. (Ky fund) ishte vetëm nga një britmë e tmerrshme që i ftohu (i bëri të vdekur) ata.

Bie perdja për ta mbuluar pamjen e tyre të mjerueshme, nënçmuese dhe poshtëruese!

## **PËRKTHIMI I AJETEVE 30-68**

- 30. O sa dëshpërim i madh për robërit që nuk u erdhi ndonjë i dërguar, vetëm se ata u tallën me të.**
- 31. A nuk e panë ata se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen.**
- 32. Dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh.**
- 33. Dhe për ata është argument (për fuqinë e Zotit) toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallëm, nxjerrim prej saj drith nga i cili ata ushqehen.**
- 34. Dhe në të Ne u kemi bërë kopshte hurmash e rrushi dhe në të u kemi dhënë burime (uji).**
- 35. Ashtu që ata të hanë nga ato fryte dhe nga çka prodhojnë vetë duart e tyre. A i gëzojnë këto dhe nuk falënderojnë?**
- 36. I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.**

37. *Për ata është argument edhe nata, prej së cilës largojmë ditën, kurse ata mbeten në terr.*
38. *Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit.*
39. *Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut (rremb i hurmës së tharë).*
40. *As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditën, po secili noton në një gjithësi.*
41. *Argument për ta është edhe ajo se Ne pasardhësit e tyre (të Ademit) i bartëm në anije të mbushur përplot.*
42. *Dhe ngjashëm me të, u krijuam atyre diçka që t'i hipnin.*
43. *E sikur të duam Ne, i përmbysim ata, e nuk ka efekt as lutja e tyre dhe as që do të shpëtonin.*
44. *Përveç nga mëshira jonë ndaj tyre dhe që të përjetojnë të mirat deri në një kohë të caktuar.*
45. *E kur u thuhet atyre: “Kini frikë asaj që ngjan para jush dhe asaj çka do t’ju ngjajë më vonë, e që të mëshiroheni (ata nuk dëgjojnë).*

46. *Nuk ka asnjë argument që u erdhi atyre nga argumentet e Zotit, e që ata nuk ia kthyen shpinën.*
47. *Dhe kur u thuhej: “Jepni nga ajo që All-llahu ju begatoi”, ata që nuk besuan besimtarëve u thanë: “A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente? Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!”*
48. *Dhe thoshin: “Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?”*
49. *(All-llahu u përgjigjet) Nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete.*
50. *E nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet - testament) e as të kthehen në familjet e tyre.*
51. *Dhe i fryhet “Surit”, kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre.*
52. *E thonë: “Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?” E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe e vërtetuan të dërguarit.*
53. *Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë të paraqitur para Nesh.*
54. *Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat.*

55. *Ata të xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi.*
56. *Ata dhe shoqet e tyre janë nën hije të mbështetur në kolltukë.*
57. *Aty ata kanë pemë dhe çka të duan.*
58. *Kanë "Selam", thënie e Zotit Mëshirues!*
59. *E tash, o ju kriminelë, ndahuni!*
60. *O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk ua dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!?*
  
61. *(Ju porosita) Të më adhuroni Mua, se kjo është rruga e sigurt!*
62. *Vërtetë, ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend?*
63. *Ky është xhehennemi që juve u premtuhej.*
64. *Hyni tash në të, për shkak se mohuat çdo të vërtetë!*
65. *Sot Ne ua mbyllim gojët e tyre, Neve na flasim duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan.*
66. *E sikur të duam Ne do t'ua verbonim sytë e tyre, e ata do ta mësynin rrugën, po si do të shihnin?*
67. *Dhe sikur të duam, do t'i kishim gjymtuar ata në vend, e nuk do të mund të shkonin as para as prapa.*

**68. E atij që i japim të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij. A nuk janë duke menduar?**

## KOMENTIMI I AJETEVE 30-68

Pas shqyrtimit të çështjes së idhujtarëve të cilët e rezistonin thirrjen e Islamit me përgënjeshtime dhe shembujve nga tregimi i fshatarëve përgënjeshtarë dhe fundi i tyre (“...Kur qe, ata të ftohur, (të vdekur)”) në mësimin e parë, në këtë mësim fillon qëndrimi i përgjithshëm i përgënjeshtarëve në çdo popull e çdo fe, pasqyron formën e njerëzimit të humbur me shekuj dhe dëshpërohet për robërit, të cilët nuk mësojnë nga fundi i kobshëm i të shkatërruarve që zhduken para tyre e nuk kthehen deri në Ditën e Gjykimit: *“Dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh...”*

Pastaj fillojnë ajetet kozmologjike, të cilat i refuzojnë e i lënë pas dore, edhe pse janë në veten e tyre, rreth tyre dhe në historinë e tyre të vjetër... Përkundrazi, ata nuk i ndiejnë, e nëse këshillohen, nuk u rikujtohet: *“Nuk ka asnjë argument që u erdhi atyre nga argumentet e Zotit, e që ata nuk ia kthyen shpinën”*.

Ata kërkojnë të shpejtohet premtimi për dënim sepse nuk besojnë: *"Dhe thoshin: 'Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?'"*

Me rastin e shpejtimit të premtimit dhe përgënjeshtimit, pasqyrohen skenat e Kijametit para tyre ashtu sikur të shihen me sy.

\* \* \*

*"O sa dëshpërim i madh për robërit që nuk u erdhi ndonjë i dërguar, vetëm se ata u tallën me të. A nuk e panë ata se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh..."*

Dëshpërimi është ndjenjë psikike ndaj gjendjes së pikëllueshme në të cilën njeriu nuk mund të ndikojë përpos të dëshpërohet e të vuaj. Zoti i Madhëruar nuk dëshpërohet ndaj robërve por deklaroi se gjendja e robërve të tillë është për dëshpërim. Gjendja e tillë është e zymtë dhe e mjerë dhe u shkakton këtyre ithtarëve dëm, shkatërrim e humbje të madhe!

O sa dëshpërim për robërit që kanë mundësi të shpëtojnë por refuzojnë. Edhe pse para tyre (prezentohen) përfundimet e kobshme të të shkatërruarve ata përsëri nuk marrin mësim e as dobi.

Zoti xh.sh. ua hap dyert e mëshirës së Vet me anë të dërgimit të kohëpaskohshëm të peygamberëve, mirëpo ata i mbyllin dyert e mëshirës dhe kanë qëndrim të keq ndaj Zotit: *“O sa dëshpërim i madh për robërit që nuk u erdhi ndonjë i dërguar, vetëm se ata u tallën me të. A nuk e panë ata se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen...!”*

Të mëparshmit që u shkatërruan gjatë viteve dhe shekujve të kaluar nuk kthehen.

Këtu ekziston një madhëri që kuptohet vetëm nga ai i cili përsiat. Por robërit e mjeruar nuk përsiasin dhe shkuan drejt rrugës së njëjtë!

A ka ndonjë gjendje më e dëshpëruar se kjo?! Pasi që kafsha rrëqethet kur e sheh vdekjen e kafshës tjetër dhe mbrohet aq sa mundet, atëherë si do të ishte me njeriun, i cili edhe pse i sheh vdekjet e njëpasnjëshme, përsëri vazhdon në të njëjtën rrugë? Mendjemadhësia e mashtron!

Historia e gjatë e vdekjeve prezentohet para syve mirëpo robërit, sikur të ishin të verbër, nuk e shohin!

Nëse të mëparshmit e shkatërruar nuk rikthehen te pasardhësit e tyre të mëvonshëm, nuk do të thotë se janë të lënë pas dore e nuk japin llogari para Zotit xh.sh. pas një kohe...*“Dhe ë gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh”.*

\* \* \*

*“Dhe për ata është argument (për fuqinë e Zotit) toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallim, nxjerrim prej saj drith nga i cili ata hanë dhe në të Ne u kemi bërë kopshte hurmash e rrushi dhe në të u kemi dhënë burime (uji), ashtu që ata të hanë nga ato fryte dhe nga çka prodhojnë vetë duart e tyre. A i gëzojnë këto dhe nuk falënderojnë? I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë”.*

Ata i përgënjeshtrojnë peygamberët, nuk mendojnë rreth fatit të përgënjeshtarëve dhe nuk e kuptojnë argumentin e jetës së tyre që zhduket e nuk kthehet.

Peygamberët thirrin në Zot dhe çdo gjë në ekzistencë ju flet për Zotin xh.sh., e argumenton Ate dhe dëshmon për qenien e Tij. Kjo është toka e afërt, të cilën e shohin të vdekur, pa jetë e pa ujë që gjallëron, pastaj e shohin të gjallë sepse mbijnë fara, mbulohet me kopshte hurmash e rrushi dhe burojnë burime uji, të cilat kudo që rrjedhin ngjallin jetë.

Jeta është mrekulli që s'mund ta krijojë dora e njeriut, por dora (fuqia) e Zotit xh.sh. është ajo që krijon mrekullira dhe i ngjallë të vdekurit.

Nëse shikohen të mbjellat e rritura, kopshtet e bukura dhe frytet e pjekura, syri dhe zemra frymëzohen me fuqinë krijuese të Zotit xh.sh., e cila e zbutë tokën për të dalë bima në liri e dritë, e gjelbëron drurin nën shkëlqimin e diellit dhe dritës, i zbukuron degët me gjethe e fryte, e çelë sythin dhe e përgatitë frytin për t'u pjekë e për t'u këputur: *“Ashtu që ata të hanë nga ato fryte dhe nga çka prodhojnë vetë duart e tyre.”*

Fuqia e Zotit xh.sh. i ka aftësuar ata për punë ashtu siç i ka aftësuar bimët për jetë e zhvillim!

*“A i gëzojnë këto dhe nuk falënderojnë?”*

Pas kësaj lidhjeje të ngushtë jetësore, kthehen dhe e madhërojnë Zotin xh.sh. për shkak se u ka krijuar bimë, kopshte dhe lloje (çifte) nga çka mban toka ashtu siç janë njerëzit dhe krijesat tjera që i di vetëm Zoti: *“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.”*

Kjo pastërti është e meritueshme sepse prezenton një të vërtetë të madhe nga të vërtetat e kësaj ekzistence, gjegjësisht e vërteta e unitetit të krijesës, e unitetit të rregullës dhe e formimit...

Zoti i ka krijuar të gjallët në palë (çifte) ashtu siç i ka krijuar edhe bimët në palë (çifte), etj.: *“Dhe nga çka ata nuk dinë”.*

Ky unitet i tillë frymëzon njësinë e fuqisë krijuese që krijon parimin e krijimit me forma, masa, lloje, gjini, karakteristika dhe cilësi të ndryshme të gjallesave, numrin e të cilave e di vetëm Zoti xh.sh...

Kush e di, ndoshta kjo është rregull e përgjithshme e gjithësisë, bile edhe deri në botën e vdekur!

Është e njohur se atomi, i cili është pjesa më e imët e materies, përbëhet prej dy palëve (çifteve) të ndryshme pozitive e negative që mbarësohen e bashkohen!

Gjithashtu janë vërejtur mijëra dysi yjore që përbëhen prej dy yjeve të lidhura ngushtë mes veti e që rrotullohen në një drejtim sikur kanë një ritëm të përbashkët!

\* \* \*

Ky ishte ajeti i tokës së vdekur, prej së cilës lindë jeta!

Pastaj vijon ajeti i qiellit dhe i fenomeneve të tij që i shohin robërit me sytë e tyre, gjegjësisht fuqinë e Zotit xh.sh. që krijon mrekullira e çudira!

*“Për ata është argument edhe nata, prej së cilës largojmë ditën, kurse ata mbesin në terr. Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit. Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet)*

*derisa të kthehet në trajtën e harkut (rrembi i hurmës së tharë). As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditën, po secili noton në një gjithësi.”*

Fenomeni i rënies së natës, në të cilën drita zhduket dhe errësira mbretëron, është një fakt i përsëritshëm që e shohin banorët e çdo vendi gjatë 24 orëve (përveç disa zonave, në të cilat dita dhe nata zgjasin me javë e me muaj, gjegjësisht në Polin e Jugut dhe Veriut). Ky ndërrim i vazhdueshëm është i çuditshëm dhe nxitë përsiatjen dhe kontemplimin.

Shprehja kur'anore rreth këtij fenomeni - në këtë vend - është e pakrahasueshme; e pasqyron ditën të mbuluar me natën, pastaj Zoti xh.sh. e nxjerr ditën prej natës: *“Kurse ata mbesin në terr.”* Ndoshta mund të kuptojmë ndonjë sekret nga ky ekspresivitet i pakrahasueshëm nëse e analizojmë nga aspekti i të vërtetës së tij. Toka e rrumbullakët rrotullohet rreth boshtit të vet përballë diellit, ashtu që çdo pjesë e saj i eksponohet dritës së diellit. Një pjesë është ditë derisa të rrotullohet toka e të largohet nga dielli dhe atëherë largohet dita e lëshohet errësira. Kështu, ky fenomen përsëritet në mënyrë të vazhdueshme dhe duket sikur drita e ditës largohet, e në vend të saj mbretëron errësira. Ky është një ekspresivitet pasqyrues më i saktë mbi të vërtetën kozmologjike.

*“Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar)”.*

Edhe dielli rrotullohet rreth boshtit të vet. Një kohë njerëzit mendonin se dielli nuk lëvizë rreth vetes, mirëpo më vonë u zbulua se nuk është trup statik por lëvizë në gjithësinë e gjerë në drejtim të caktuar edhe ate (sipas konstatimeve të astronomëve) me një shpejtësi prej 12 miljesh (19 km) në sekondë!

Zoti xh.sh. i cili më së miri e di lëvizjen dhe rrotullimin e diellit thotë se udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Këtë cak përfundimtar nuk e di askush përpos Zotit të Madhëruar!

Kur e kemi të ditur se dielli është më i madh se toka për afër një milion herë dhe se një trup i tillë grandioz lëvizë e rrotullohet në gjithësi pa kurrfarë mbështetje, kuptojmë një pjesë të fuqisë dhe diturisë që e rregullojnë këtë ekzistencë: *“Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit”.*

*“Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut (rrembi i hurmës së tharë).”*

Njerëzit e vërejnë edhe hënën që kalon nëpër fazat e veta, fillon në trajtën e harkut që me kalimin e netëve ta merr trajtën e rumbullakët (hëna e plotë). Pastaj përsëri fillon të ndryshojë e ta merr formën e harkut (si rrembi i hurmës së tharë).

Ai, i cili e vështron hënën netë me radhë, e kupton domethënien e thënies kur'anore: *"Derisa të kthehet në trajtën e harkut"*.

Edhe pse hëna gjatë netëve të para dhe atyre të fundit ka formën e harkut, përsëri vërejmë se në netët e para karakterizohet me shkëlqim e freski, kurse në ato të fundit me zbehtësi, pamje të zymtë, lodhje e dobësi, kryesisht si rrembi i hurmës së tharë!

Kjo është domethënia e termit *"Kadim"*!

Pra, nuk është e rastit që Kur'ani të flet për të (hënën) me këtë term inspirues e të çuditshëm!

Dhe në fund cakton përkryerjen e sistemit qiellor, planetëve të mëdha dhe lëvizjeve të përpikta e të unjësuar të fenomeneve:

*"As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditën, po secili noton në një gjithësi"*.

Çdo yll apo planet ka gjithësinë e vet ose vendqarkullimin të cilit nuk i shmanget gjatë lëvizjes apo rrotullimit. Largësitë mes yjeve dhe planetëve janë të mëdha, p.sh. largësia mes tokës sonë dhe diellit është afër 93.000.000 milje (150.000.000 km), ndërsa hëna prej tokës 240.000 milje (rreth 390.000 km). Këto largësi nuk janë asgjë në krahasim me largësitë mes sistemit tonë diellor dhe yllit më të afërm të sistemeve tjera që janë afër 4 vjet drite,

ndërsa shpejtësia e dritës është 186,000 milje në sekondë (300. 000 km/s) (vetë mund ta llogaritni se sa milionë milje është kjo largësi!)

Zoti, i cili e krijoi këtë gjithësi madhështore, i caktoi këto largësi të mëdha mes yjeve dhe planetëve. Ai e krijoi gjithësinë në këtë formë për ta mbrojtur nga ndeshjet dhe aksidentet - deri në ditën e caktuar. Dielli nuk mund ta arrijë hënën e as nata ditën. Nuk ka pengim në rrugë ngase qarkullimi natë-ditë nuk çrregullohet asnjëherë për shkak të këtij sistemi!

*“Secili noton në një gjithësi!”*

Lëvizja e këtyre trupave në gjithësinë e gjerë i ngjanë lëvizjes së anijeve në oqeanin e gjerë, të cilat edhe pse janë të mëdha, përsëri duken si pika notuese në atë sferë.

Njeriu e ndjen veten tepër të vogël kur i sheh këto miliona yje qarkulluese që nuk mund të numërohen, që janë të shpërndarë në gjithësi e që lundrojnë në oqean. Hapësira përreth tyre është shumë e gjerë ndërsa trupat e mëdhenj enden në atë horizont të paskaj!!!

\* \* \*

*“Argument për ta është edhe ajo se Ne pasardhësit e tyre (të Ademit) i bartëm në anije të mbushur përplotë. Dhe ngjashëm me të, u krijuam atyre diçka që t'i hipnin. E sikur të duam Ne, i përmytim ata, e nuk ka efekt as lutja e tyre dhe as që do të shpëtonin, përveç nga mëshira jonë ndaj tyre dhe që të përjetojnë të mirat deri në një kohë të caktuar”.*

Në këtë kontekst ekziston një lidhshmëri e bukur mes yjeve e planetëve lundruar dhe anijes së mbushur përplotë e që lundron me pasardhësit e Ademit! Kjo është lidhshmëri në formë, në lëvizje, në nënshtrimin e të dyjave para urdhrit të Zotit xh.sh. dhe nën mbrojtjen e Tij të qiejve dhe të tokës.

Edhe këtë shenjë e shohin njerëzit (robërit e Zotit) por nuk e analizojnë; kjo do të ishte më e afërt dhe më e lehtë në qoftë se i hapin zemrat para shenjave! Ndoshta anija e përplotë që ceket këtu, mund të jetë ajo e Nuhit, babait të dytë të njerëzimit, e cila i barti pasardhësit e Ademit.

Zoti e mundësoi që me anije të tilla të kapërcehen valët!

Ata i mbajti fuqia e Zotit xh.sh., i cili ka krijuar rregulla për gjithësinë.

Fuqia e Tij e bëri gjithësinë të lundrojë në ujë. Horizontet e gjithësisë, ujit, erës, avullit, e fuqisë

nga atomi ose fuqive tjera janë çështje, krijesa dhe caktime të Zotit!

*“E sikur të duam Ne, i përmytim ata, e nuk ka efekt as lutja e tyre dhe as që do të shpëtonin, përveç nga mëshira jonë ndaj tyre dhe që të përjetojnë të mirat deri në një kohë të caktuar”.*

Anija në oqean është skur gjethi në ajër pa marrë parasysh madhësinë dhe efikasitetin e saj, por mëshira e Zotit xh.sh. e mbron sepse ajo mund të shkatërrohet në një çast të natës apo të ditës. Udhëtarët që hipin qoftë në barkë apo në anije të madhe që lundron në oqean, e kuptojnë frikën nga deti dhe mundësitë e pakta (e të kufizuara) për t'u mbrojtur nga rreziku dhe tërbimi i madh i ujit. Në këtë rast ata e ndejnë domethënien e mëshirës së All-llahut dhe se kjo është mbrojtje e vetme për ta kur rrezikohen nga stuhitë dhe shtrëngatat. Këtë krijesë madhështore e mbron mëshira hyjnore e jo ndonjë fuqi tjetër, qoftë në tokë apo në qiell deri në një kohë të caktuar kur do të realizohet premtimi i të Urtit dhe të Gjithëditurit: *“Deri në një kohë të caktuar”.*

\* \* \*

Edhe pse ekzistojnë argumente të qarta, përsëri njerëzit janë në gjumë, nuk shohin, nuk i zgjojnë zemrat dhe nuk përfundojnë me talljet e

përgënjeshtimet, bile kërkojnë që të shpejtohet dënimi, për të cilin të dërguarit ua tërhoqën vërejtjen:

*“E kur u thuhet atyre: 'Kini frikë asaj që ngjau para jush dhe asaj çka do t'ju ngjajë më vonë, e që të mëshiroheni (ata nuk dëgjojnë)'. Nuk ka asnjë argument që u erdhi atyre nga argumentet e Zotit, e që ata nuk ia kthyen shpinën. Dhe kur u thuhej: 'Jepni nga ajo që All-llahu ju begatoi', ata që nuk besuan, besimtarëve u thanë: 'A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente? Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!' Dhe thoshin: 'Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?'”*

Këto ajete nuk ndikojnë në zemrat e tyre (përgënjeshtarëve dhe mëkatarëve) që të përsiasin, analizojnë, ndiejnë e të jenë të devotshëm mirëpo ndikojnë në zemrën e hapur dhe shkaktojnë tronditje, dridhje dhe revolucion.

Në këtë libër të hapur, çdo faqe tregon madhërinë, krijimin e përpiktë dhe fuqinë e Krijuesit mirëpo të verbërit këtë nuk e shohin, e nëse e shohin, nuk e analizojnë. All-llahu xh.sh., për shkak të mëshirës së vet të madhe, nuk i la ata pa peygamber që ua tërhoq vërejtjen, i udhëzon dhe i thërret në Zotin e kësaj gjithësie dhe Krijuesin e ekzistencës, nxitë në zemrat e tyre ndjenja, frikë e devotshmëri dhe ua tërhoq vërejtjen nga pasojat e hidhërimit dhe dëmit.

(Shenjaj) janë përreth tyre, para syve dhe pas shpine; edhe pse nuk i vërejnë, ata i hasin në çdo hap prej hapave të tyre; ajetet kozmologjike shtohen edhe më tepër kudo që drejtohen mirëpo ata përsëri ngelin në verbërinë e tyre:

*“E kur u thuhet atyre: 'Kini frikë asaj që ngjau para jush dhe asaj çka do t'ju ngjajë më vonë, e që të mëshiroheni (ata nuk dëgjojnë)'. Nuk ka asnjë argument që u erdhi atyre nga argumentet e Zotit, e që ata nuk ia kthyen shpinën”.*

E nëse thirren të kontribuojnë vullnetarisht nga pasuria e tyre për t'i ushqyer të varfërit, atëherë thonë me tallje e nënçmim: *“A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente?”*

Ata ngritën zërin kundër atyre që thirrnin në mirësi e në kontribut vullnetar duke thënë: *“Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!”*

Botëkuptimi i tillë i tyre na bënë të kuptojmë se nuk i kanë kuptuar rregullat e Zotit në jetën e robërve. Zoti xh.sh. është ushqyes e furnizues i të gjithëve dhe çdo furnizim që është në tokë për robërit (njerëzit), është krijim i Tij. Ata nuk kanë krijuar asgjë për vete bile as që janë të aftë të krijojnë diçka, mirëpo dëshira e Zotit për zhvillimin e kësaj toke bëri që njerëzit të kenë nevojë për gjërat që i përfitojnë me punë e mund. Bujqësia në tokë,

përpunimi i tokës së thatë, transferimi i pasurive të saj prej një vendi në tjetër dhe shfrytëzimi i këtyre të mirave që blehen me shkëmbim, monedha ose me gjëra të çmueshme ndryshojnë me ndryshimin e kohës dhe vendit. Gjithashtu edhe njerëzit janë krijuar me prirje e aftësi që janë të lidhura ngushtë me nevojat e mëkëmbjes së plotë në këtë tokë. Kjo mëkëmbje s'ka nevojë vetëm për prirje e aftësi që kanë të bëjnë me grumbullimin e pasurive dhe ushqimeve, por ka nevojë edhe për gjëra të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e nevojave elementare të mëkëmbjes njerëzore në tokë.

Në këtë masë të gjerë të nevojave e kërkesave të mëkëmbjes dhe të aftësive e prirjeve të domosdoshme për përfitime e furnizime si dhe të konfrontimit e ballafaqimit mes fateve njerëzore, në këtë masë të gjerë me varg të vazhdueshëm jo vetëm për një gjeneratë por për gjenerata të ndryshme të afërta e të largëta, në të kaluarën, të tashmen e të ardhmen, dhe në këtë masë të gjerë të furnizimeve të ndryshme të njerëzve, eventualisht për të mos shkaktuar ky ndryshim dëmtimin e jetës dhe shoqërisë, edhe pse është formuar nga lëvizja e jetës për realizimin e njeriut në tokë (duke e marrë parasysh gjithë këtë), Islami i zberthen kërkesat e nevojshme individuale me marrjen e një pjese të

caktuar nga të pasurit për t'i siguruar nevojat themelore e jetike të të varfërve.

Në këtë mënyrë pastrohen shumë shpirta të të varfërve e të pasurve. Islami e quajti këtë (veprim) "zekat", që do të thotë "pastrim". Ky kontribut i obligueshëm është edhe adhurim! Kështu i bashkoi të varfërit me të pasurit në shoqërinë e tij që e formoi në mënyrë ideale e të pakrahasueshme.

Deklarimi i atyre që nuk e kuptojnë urtësinë e Zotit xh.sh. në jetë: *"A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente!?"*, dhe qëndrimi jonjerëzor ndaj predikuesve të kontributit edhe atë duke thënë: *"Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!"*, janë dështim i vërtetë për shkak të mosnjohjes së natyrës të rregullave të Zotit xh.sh., të ecurisë së jetës, të madhërisë së kësaj ecurie dhe madhështisë së qëllimit, për shkak të të cilit aftësitë dhe prirjet bëhen të llojlojshme dhe shpërndahen pasuritë e furnizimet.

Islami përcakton sistem që siguron drejtësinë për çdo individ, pastaj lejon aktivitetin njerëzor të ndryshëm e të domosdoshëm për mëkëmbje në tokë që të zhvillohet në mënyrë të pastër, e më vonë i eliminon gjurmët negative me masat e veta preventive.

Dhe në fund vijon dyshimi dhe tallja e tyre me premtimin: *"Dhe thoshin: 'Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?'"*

Premtimi i Zotit xh.sh. nuk shpejtohet për shkak se njerëzit kërkojnë një shpejtim të tillë e as që vonohet për shkak të lutjeve të tyre, sepse çdo gjë te Zoti është e caktuar dhe ka kohën e vet. Gjërat ndodhin sipas urtësisë së amshueshme të Zotit që vë çdo gjë në vendin e vet dhe çdo ngjarje në kohën e caktuar.

Çdo gjë në këtë gjithësi lëvizë sipas sistemit të shkruar e të caktuar në librin e ruajtur (Levhi-Mahfudh).

Përgjigjja e kësaj pyetjeje të gabuar do të ceket kur do të bisedohet për një skenë nga skenat e shumta të kijametit, eventualisht në të do të shohin se si do të ndodhë e jo kur do të ndodhë...

\* \* \*

*"(All-Ilahu u përgjigjet) Nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete, e nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet-testament) as të kthehen në familjet e tyre. Dhe i fryhet "Surit", kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre e thonë: 'Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?' E, kjo është ajo që e premtoi Zoti dhe e vërtetuan të*

dërguarit. Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë të paraqitur para Nesh”.

Përgënjeshtarët, në pyetjen e tyre: “Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?”, marrin përgjigje të shpejtë me një skenë (që përbëhet) prej një zëri që e bënë të vdekur çdo të gjallë dhe që e përfundon jetën se bashku me gjallesat:

*“(All-llahu u përgjigjet) Nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete, e nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet-testament) as të kthehen në familjet e tyre”.*

Ajo britmë i rrëmben papritmas kur janë të zënë mes vete e polemizojnë në betejën e jetës, kurse ata jo vetëm që nuk e presin por as që e paramendojnë atë. Papritmas përfundojnë ashtu siç janë, pa u lënë porosi pasardhësve e as që mund të kthehen në familjet e tyre e t’ju thonë ndonjë fjalë...

Ku janë ata?

Edhe ata si ai janë të vdekur (kanë përfunduar jetën!).

Pastaj fryhet “suri” e ata dalin nga varrezat dhe shpejtojnë. Ashtu të habitur e të frikuar pyesin: “Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?” Më vonë qetësohen pak sepse kuptojnë dhe

informohen: *“E, kjo është ajo që e premtoi Zoti dhe e vërtetuan të dërguarit”.*

Pastaj ndihet zëri i fuqishëm i fundit.

Ky është vetëm një zë.

Papritmas ky, i shkatërruar, i hutuar, i habitur dhe me një shpejtësi të çuditshme rikthehet: *“Dhe ata të gjithë të paraqitur para Nesh”.*

Kështu radhiten rreshtat, përgatitet eksponimi me një shpejtësi të madhe dhe papritmas dëgjohet vendimi suprem për karakterin e qëndrimit, llogarisë dhe shpërblimit mbi të gjithë:

*“Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat”.*

Në këtë shpejtësi të madhe me të cilën përfundojnë tri skenat, ekziston lidhshmëria me kundërshtimin e atyre që dyshuan në ditën e premtuar e të njohur!

Pastaj vijon shpërblimi i besimtarëve dhe rrëfëhet kënaqësia e tyre: *“Ata të xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi. Ata dhe shoqet e tyre janë nën hije të mbështetur në kolltukë. Aty ata kanë pemë dhe çka të duan. Kanë “Selam”, thënie e Zotit Mëshirues!”*

Ata aty janë të preokupuar me begatitë dhe jetojnë të kënaqur e të gëzuar!

Ata janë nën hije, pushojnë nën flladin e puhisë dhe janë të mbështetur në kolltukë e kënaqen së bashku me bashkëshortet e tyre. Aty kanë pemë dhe çka të duan si dhe realizojnë çdo dëshirë.

Përpos këtij respekti e nderimi, ata aty kanë “Selam-in” që e pranojnë nga Zoti i tyre fisnik: “*Thënie e Zotit Mëshirues!*”

Në kontekst nuk mbulohet çështja e llogarisë së të tjerëve, por rrëfëhet dhe paraqitet me urrejtje dhe nënçmim:

*“E tash, o ju kriminelë, ndahuni! O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk u dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!? (Ju porosita) të më adhuroni Mua, se kjo është rruga e sigurt! Vërtetë ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend? Ky është xhehennemi që juve u premtuhej. Hyni tash në të, për shkak se mohuat çdo të vërtetë!”*

Ata nënçmohen e poshtërohen: “*E tash, o ju kriminelë, ndahuni!*”, largohuni nga besimtarët!

*“O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk u dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!?”*

Thirrja “*O bijtë e Ademit*” këtu nënkupton nënçmimin. Djalli (shejtani) e nxori babën e tyre nga

parajsa (xhenneti), kurse ata pastaj e adhurojnë edhe pse është armiku i tyre i përbetuar.

*“(Ju porosita) të më adhuroni Mua, se kjo është rruga e sigurt!”*

Eja te Unë dhe prano pëlqimin Tim!

Ju nuk keni patur kujdes ndaj armikut tuaj që ka humbur shumë gjenerata... *“A nuk mblohdhët mend?”*

Në fund të këtij qëndrimi të vështirë e të kobshëm, proklamon dënimin e dhembshëm me një ironi e sarkazëm:

*“Ky është xhehennemi që juve u premttohej. Hyni tash në të, për shkak se mohuat çdo të vërtetë!”*

Kjo skenë nuk ngelë vetëm me këtë qëndrim të dhembshëm, por vazhdon edhe një skenë e re e çuditshme: *“Sot ne ua mbyllim gojët e atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan”.*

Kështu poshtërojnë njëri-tjetrin, dëshmojnë kundër tyre gjymtyrët e tyre, copëtohet personaliteti i tyre pjesë-pjesë dhe përgënjeshtrojnë njëri-tjetrin ashtu që çdo organ i kthehet Zotit në mënyrë individuale dhe çdo gjymtyrë i kthehet Krijuesit të vet e dorëzuar!

Kjo është një skenë e çuditshme dhe e tmerrshme, që i frikëson zemrat po që se edhe vetëm e parafytyrojnë!

\* \* \*

Gjithashtu skena përfundon, gjuhët lidhen, duart flasin dhe këmbët dëshmojnë, gjë që nuk ka qenë më parë e rëndomtë e as që e kanë pritur. Sikur të dëshironte Zoti xh.sh., do të vepronte ndryshe e do t'i dënonte sa të donte. Këtu prezentohen dy lloje dënimi prej të cilave Zoti do ta zgjedhte atë që dëshironte:

*“E sikur të duam Ne do t'ua verbonim sytë e tyre, e ata do ta mësynin rrugën, po si do të shihnin? Dhe sikur të duam, do t'i kishim gjymtuar ata në vend, e nuk do të mund të shkonin as para as prapa”.*

Në këto dy skena dënimi theksohet për nënçmim e tallje, nënçmim për përgënjeshtarët dhe tallje për tallësit të cilët thoshin: *“Po që se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?”*

Në skenën e parë, ata janë të verbër dhe ashtu të verbër ia mësyjnë rrugës, shtyhen në kalim dhe shkaktajnë trazira ashtu siç bëjnë të verbërit kur dalin në gara, bile edhe rrëzohen ashtu siç rrëzohen të verbërit në këto raste: *“Po si do të shihnin?!”*

Në skenën e dytë, ata ndalen papritmas në vend, s'mund të ecin as para e as prapa edhe pse pak më

parë ishin të verbër që ia mësyen rrugës dhe hutohen!

Në të dy skenat ata duken si kukulla e lojëra, të tallur e të nënçmuar, mirëpo pak më parë talleshin me premtimin (e Zotit) dhe e nënçmonin!

E gjithë kjo do të ndodhë kur do të afrohet koha e caktuar, për të cilën kërkojnë të shpejtohet...

Sikur të qëndrojnë në tokë, të jetojnë gjatë dhe t'u jep pak kohë premtimi i caktuar, ata do të shkojnë në drejtim të së keqes dhe do ta falënderojnë shpejtimin.

Ata plaken e pastaj kthehen prapa në krijimin e tyre: *“E atij që i japim të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij. A nuk janë duke menduar?”*

Pleqëria kthehet prapa në fëmijëri pa e patur kënaqësinë dhe pastërtinë e dashur të fëmijërisë!

Plaku vazhdimisht kthehet në krijim, harron atë që e ka ditur, i dobësohen nervat dhe i dobësohet mendja derisa bëhet përsëri fëmijë.

Fëmija është i dashur, i buzëqesh zemra dhe fytyra për çdo gjest të marrë, kurse plakut i drejtohen nga mëshira e rahmeti si dhe gjithmonë është i tallur kur vepron ashtu siç vepron fëmija, kur bën marri dhe kur kërruset nga mosha!

Ky dënim i pret përgënjeshtarët, të cilët Zoti xh.sh.  
nuk i nderon me besimin (imanin) e drejtë e fisnik...

## PËRKTHIMI I AJETEVE 69-83

69. *Ne as nuk ia mësuam atij (Muhammedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë.*
70. *Për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë (me mend e me zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët.*
71. *A nuk e shohin ata se nga ajo që Ne vetë e shpikëm, u krijuam atyre kafshë që ata i kanë.*
72. *Dhe ua bëmë ato që t'u binden atyre, e disave prej tyre u hipin, ndërsa prej disave ushqehen.*
73. *Ata kanë edhe dobi të tjera në to, e edhe pinë (qumësht) prej tyre. A nuk duhet të falënderojnë?*
74. *Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre.*
75. *Ata nuk mund t'u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) janë bërë ushtri e gatshme e tyre.*

76. *E ty të mos brengosin thëniet e tyre, Ne dimë çka mbajnë ata fshehtë e çka publikojnë.*
77. *A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pikë uji (fare), kur qe, ai, kundërshtar i rreptë.*
78. *Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: “Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur”?*
79. *Thuaj: “I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim.”*
80. *Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni.*
81. *A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikur që i krijoi ata? Po, Ai është Krijuesi, i Dijshtëmi.*
82. *Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t’i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet.*
83. *I lartë është Ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm te Ai ktheheni.*

## KOMENTIMI I AJETEVE 69-83

Në pjesën e fundit të sures përmenden të gjitha çështjet që i shqyrtoi kjo sure: çështja e shpalljes dhe natyrës së saj, çështja e hyjnisë dhe njëjesisë së Zotit xh.sh. si dhe çështja e ringjalljes dhe rilindjes... Të gjitha këto çështje paraqiten në forma të shkurtra që kanë ritme të thella me ndikim të madh.

E gjithë kjo pasqyron fuqinë që krijon dhe udhëzon çdo gjë në këtë gjithësi. Ky nocion përqëndrohet në fund të sures me ajetin përfundimtar:

*"I lartë është Ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm te Ai ktheheni..."*

Kjo dorë e fuqishme dhe krijuese i ka krijuar kafshët për njerëzit dhe i ka bërë të atyre (njerëzve), e ka krijuar njeriun prej një pikë uji (sperme), i ringjallë eshtrat e kalbura ashtu siç i ka krijuar për herë të parë, e ka formuar zjarrin prej drurit të gjelbërt, i ka krijuar qiejt dhe tokën dhe në fund, ajo ka pushtetin mbi çdo send në këtë ekzistencë... Këto ishin karakteristikat e pjesës së fundit...

*“Ne as nuk ia mësuam atij (Muhammedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kur’ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur’an i qartë për t’ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë (me mend e me zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët”.*

Çështja e shpalljes u cek në fillim të sures:

*“Ja, Sinë! Pasha Kur’anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë! S’ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve. Je në një rrugë të drejtë. (Kur’ani është) zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit, për t’ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar...”*

Tash vijon kritika ndaj disave që e paraqitnin Muhammedin a.s. si poet dhe Kur’anin e zbritur si poezi.

Jo që se kuptonin kurejshitet se çështja nuk është ashtu dhe se ajo, që ua solli Muhammedi a.s. është jo e rëndomtë në gjuhën e tyre si dhe jo që se dallonin Kur’anin prej poezisë, por e gjithë kjo ndodhte vetëm për ta luftuar fenë e re dhe predikuesin e saj (Muhammedin a.s.) para masës së popullit, edhe ate duke u mbështetur në faktin se ndoshta bukuria ndikuese e tekstit kur’anor mund të ndikojë në popull e ta përziejë me poezinë.

Këtu Zoti i Madhëruar mohon se i Dërguari e ka njohur poezinë, eventualisht nëse Zoti nuk ia ka mësuar, atëherë nuk do ta mësojë sepse njeriu di vetëm atë që ia mëson Zoti xh.sh.

Pastaj mohon lidhjen e të Dërguarit me poezinë: “*E as që i takon atij*”, sepse metoda e poezisë ndryshon nga ajo e peygamberisë. Poezia është ndjenjë emocionale dhe njoftim për këtë ndjenjë.

Ndjenja emocionale ndryshon prej një gjendje në një gjendje tjetër.

Pejgamberia është shpallje, ka metodë konstante, është në rrugë të drejtë, përcjell ligjin e pandryshueshëm të Zotit që mbizotëron në mbarë ekzistencën dhe nuk ndryshon ashtu siç ndryshojnë ndjenjat dhe poezia nën ndikimin e emocioneve të përtërira dhe epsheve urgjente, të cilat nuk janë stabile.

Pejgamberia është lidhje e përhershme me Zotin, mësim i drejtpërdrejtë nga shpallja e Zotit dhe orvatje e përhershme për udhëzimin e jetës në drejtim të Zotit, kurse poezia (forma e saj më e lartë) është anim njerëzor kah bukuria dhe përkryerja me forma dhe parafytyrime të kufizuara për shkak të kufizimit të njohurive dhe prirjeve të njeriut. Kur zbret nga format e larta, atëherë poezia

paraqet ndjenjat dhe emocionet që janë rrënkim trupi dhe gufim.

Natyra e peygamberisë dhe ajo e poezisë ndryshojnë që në esencë. Poezia e formës më të lartë është ndjenjë që ngritet prej toke kurse peygamberia në esencë është udhëzim i zbritur nga qielli.

*“Ai (Kur’ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur’an i qartë.”*

Këshilla dhe Kur’ani janë dy cilësi të një gjëje, gjegjësisht këshillë sipas funksionit dhe Kur’an sipas leximit. Ai është këshillë e Zotit për në zemër dhe Kur’an për shkak se lexohet me gjuhë. Kur’ani është i zbritur për të kryer një funksion të posaçëm: *“Për t’ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë (me mend e me zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët”.*

Kur’ani e vë mosbesimin përballë jetës. Mosbesimin e bën vdekje kurse aftësinë e zemrës për besim, jetë. Pastaj tregohet funksioni i Kur’anit se i është shpallur Peygamberit a.s. për t’ia tërhequr vërejtjen të gjallit sepse në të ka sukses, kurse mosbesimtarët janë të vdekur dhe nuk e dëgjojnë tërheqjen e vërejtjes. Sa u përket këtyre, detyra e Kur’anit është të regjistrojë meritën për dënim sepse

All-llahu nuk e dënon askend derisa t'i vijë shpallja e pastaj vendosë e shkatërron pa argument e pa falje!

Kështu i mëson njerëzit se ata para këtij Kur'ani, janë dy grupe: grupi që përgjigjet e që është i gjallë dhe grupi që nuk përgjigjet e që është i vdekur. Ai gjithashtu i mëson se ky grup (grupi dëgjues) meriton shpërblim kurse grupi tjetër (grupi i padëgjueshëm) meriton dënim!

\* \* \*

Pjesa e dytë paraqet çështjen e hyjnisë dhe njëjesisë së Zotit xh.sh. nga prizmi i njerëzve që i shohin gjërat dhe nga prizmi i begative të Krijuesit, që janë krijuar për ta, por nuk falënderojnë:

*“A nuk e shohin ata se nga ajo që Ne vetë e shpikëm, u krijuam atyre kafshë që ata i kanë dhe ua bëmë ato që t'u binden atyre, e disave prej tyre u hipin, ndërsa prej disave ushqehen. Ata kanë edhe dobi të tjera në to, e edhe pinë (qumësht) prej tyre. A nuk duhet të falënderojnë? Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre. Ata nuk mund t'u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme e tyre. E ty të mos brengosin thëniat e tyre, Ne dimë çka mbajnë ata fshehtë dhe çka publikojnë”.*

A nuk shohin?!

Ja, shenja e Zotit është e qartë para tyre, nuk është e fshehtë, as e largët e as e pakuptuar e që ka nevojë për përsiatje e kontemplim. Aty janë kafshët që i krijoi Zoti për ta dhe i bëri në shërbim të njerëzve, u hipin, i hanë, pijnë qumështin e tyre etj. E gjithë kjo është me fuqinë dhe krijimin e Zotit; Ai i krijoi karakteristikat specifike të njerëzve dhe të kafshëve. Ai i aftësoi njerëzit t'i nënshtrojnë, t'i shfrytëzojnë dhe të kenë dobi prej tyre, kurse kafshët i krijoi për t'i plotësuar nevojat e njeriut.

Njerëzit s'kanë aftësi të krijojnë diçka nga e gjithë kjo, bile as edhe një mizë! Ata nuk mund ta nënshtrojnë edhe një mizë sepse Zoti nuk i ka dhuruar asaj karakteristika të tilla...

*“A nuk duhet të falënderojnë?”*

Nëse njeriu e vërenë këtë fakt në këtë mënyrë dhe nga ky prizëm që theksohet në Kur'an, atëherë do të bindet se është i mbushur me plotë begati nga Zoti xh.sh., me begati që gjenden rreth e përqark tij.

Çdo herë kur i hipë kafshës, kur ha ndonjë copë mishi, kur pi qumësht, kur ha një copë tëlyen ose djath, kur veshë rroba nga leshi, lëkura ose rroba me qime të ashpra etj., gjithmonë e ndien në vete instinktivisht ekzistencën, mëshirën dhe begatinë e Krijuesit të Madhëruar. Ai këtë e përjeton në çdo gjë që e prekë me dorë rreth vetes dhe në çdo gjë që e

shfrytëzon në këtë gjithësi, qoftë e gjallë apo jo. Kështu, tërë jetën i falënderohet All-llahut dhe e adhuron natë e ditë.

Por njerëzit nuk falënderojnë, bile disa prej tyre këto i kanë marrë si zota përveç All-llahut: *“Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre. Ata nuk mund t’u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme e tyre”*.

Në të kalurën, zota ishin putat, idhujt, drunjte, yjet, engjëjt, xhinët... Idhujtaria edhe sot e kësaj dite ekziston në disa vise të tokës. Nuk do të thotë se ata të cilët nuk i adhurojnë këto puta, janë të sigurtë ndaj monoteizmit, por përkundrazi, idhujtaria e tyre sot paraqitet në besimin në forca të rrejshme përpos forcës së Zotit dhe në mbështetjen në gjëra të tjera përpos mbështetjes në Zotin xh.sh. Idhujtaria është e llojlojshme dhe ndryshon me ndryshimin e kohës dhe vendit.

Ata i adhuronin ata zota me qëllim që të fitojnë, mirëpo ndodhte e kundërta, ata i mbronin zotat e tyre nga sulmi eventual i armikut ose i dëmtuesit, pra, ata ishin bërë ushtri e gatshme e tyre për t’i mbrojtur: *“Por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme...”*

Ky ishte kulmi i konceptit dhe mendimit të marrë, mirëpo edhe sot e kësaj dite shumica e njerëzve nuk largohen nga kjo marrëzi, pra ka ndryshuar vetëm forma (e idhujtarisë).

Ata të cilët i hyjnizojnë sot tiranët dhe diktatorët nuk dallohen shumë nga adhuruesit e atyre putave dhe idhujve. Këta janë ushtarë të gatshëm për diktatorët; ata i mbrojnë edhe ata edhe tiraninë e tyre, e në të njëjtën kohë u përkulen!

Idhujtaria me të gjitha format e saj mbetet idhujtari.

Kudo që tronditet besimi i singertë monoteist vijon idhujtaria dhe xhahilijeti (injanca)!

Njerëzimin e mbron vetëm monoteizmi i singertë, i cili ia kushton hyjninë, adhurimin, animin, mbështetjen, nënshtrimin dhe madhërimin vetëm Zotit xh.sh.

*“E ty të të mos brengosin thëniet e tyre, Ne dimë çka mbajnë ata fshehtë dhe çka publikojnë”.*

Kjo i drejtohet Muhammedit a.s., i cili u gjend ballë për ballë me ata të cilët besojnë zota tjerë përveç All-llahut, nuk falënderojnë e as që e përmendin (Zotin), me qëllim që të qetësohet.

Ata janë të zbuluar në diturinë e Zotit dhe Ai di çdo vepër e çdo gjë që e posedojnë, pra, s'duhet të frikohet i Dërguari prej tyre. Çështja e tyre është e

zbuluar para fuqisë së Tij të madhe dhe se Zoti di çdo gjë për ta.

Në këtë mënyrë, çështja e tyre u dobësua sepse besimtari që mbështetet në Zotin, nuk frikohet nga rreziku prej tyre për shkak se e di se Zoti di çka mbajnë ata në fshehtësi dhe çka publikojnë; se janë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Tij, kur ja, ata nuk e ndiejnë këtë.

\* \* \*

Pjesa e fundit e kësaj sureje shqyrton çështjen e ringjalljes dhe rilindjes:

*“A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pikë uji (fare), kur qe, ai, kundërshtar i rreptë. Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: 'Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?' Thuaj: 'I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim.' Ai që prej drurit të gjelbër ua bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni. A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikundër që i krijoi ata? Po Ai është Krijuesi, i Dijshtëmi. Kur ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet.”*

Kjo pjesë fillon me njeriun që ballafaqohet me realitetin vetjak. Ky realitet e paraqet krijimin dhe zhvillimin e tij ashtu siç e sheh të realtë në jetën e

tij. Ai e sheh këtë me sytë dhe me shqisat e veta në mënyrë të përsëritshme dhe të përtërirë, mirëpo nuk e shikon me vëmendje argumentin e tij e as që e pranon premtimin e Zotit si të vërtetë për ringjalljen dhe rilindjen e tij pas vdekjes dhe shkatërrimit: *“A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pikë uji (fare) kur qe, ai, kundërshtar i rreptë!”*

Ç’është “pika e ujit (fara)”, për të cilën s'mund të dyshojë njeriu se është burim i tij i afërt?

Ajo është një pikë uji e pavlefshme e që ka mijëra qeliza, prej të cilave vetëm një zhvillohet në embrion, e pastaj bëhet njeri që polemizon dhe kundërshton Zotin e tij si dhe kërkon prej Tij fakt e argument.

Fuqia krijuese është ajo që e shndërron këtë pikë uji (farë) në kundërshtar të rreptë.

Sa i largët është transferimi mes formimit dhe rrugës zhvilluese!

A thua kundër kësaj fuqie që e rikthen dhe e ringjallë pas shkatërrimit dhe zhdukjes, ngritet njeriu?

*“Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: 'Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?’  
Thua: 'I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim’.”*

Sa e rëndomtë është kjo!

Sa logjikë e bukur është kjo e instinktit!

Logjikë e realltë, e afërt dhe e vërtetë!

Kjo pikë e ujit (fara) a u jep eshtrave të kalbur e të copëtuar fuqi, jetë dhe vlerë?

A nuk u krijua njeriu prej kësaj pike?

A nuk ishte ky formimi i parë?

A s'është i aftë Ai që e shndërroi këtë pikë në njeri dhe njeriun në kundërshtar të rreptë t'i shndërrojë edhe eshtrat e kalbura në një krijesë të gjallë e të re?

Pasi që kjo çështje është shumë e lehtë, atëherë pse të zhvillohet polemikë e gjallë?!

*"Thuaj: 'I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim'."*

Pastaj e qartëson më tepër natyrën e fuqisë krijuese dhe krijimin e saj në bazë të asaj që e kanë para dhe prapa tyre: *"Ai që prej drurit të gjelbër bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni"*.

Shikimi i parë e i rëndomtë e konfirmon me sinqeritet këtë çudi, gjegjësisht çudinë, përreth së cilës kalojnë pa e vërejtur.

Është çudi se ky dru i gjelbër e i mbushur me ujë, në bazë të fërkimit formon zjarrin, e pastaj edhe vetë digjet pas gjelbërimit dhe lagështisë...

Njohja e thellë shkencore mbi natyrën e energjisë që është e deponuar në drurin e gjelbër nga thithja e energjisë diellore dhe që ruhet në të edhe pse është përplotë ujë e gjelbërim dhe që formon zjarrin nga fërkimi ashtu siç formohet edhe gjatë djegies, e qartëson edhe më shumë këtë çudi para syve.

Krijuesi është Ai i cili ia dhuroi drurit këto karakteristika dhe i cili krijoi çdo gjë e pastaj e udhëzoi, mirëpo pasi që ne nuk i shohim syçelë këto gjëra e as që i analizojmë me vëmendje, ato nuk na zbulojnë fshehtësitë e veta të çuditshme dhe nuk na tregojnë Krijuesin e ekzistencës. Sikur t'ua hapnim zemrat tona, atëherë do të na zbulonin fshehtësitë e veta dhe do të bashkëjetonim në adhurim e madhërim të përhershëm!

Pastaj vazhdon pasqyrimin e argumenteve të fuqisë dhe detajizimin e çështjes së krijimit dhe ringjalljes të të gjithë njerëzve: *“A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikundër që i krijoi ato? Po, Ai është Krijuesi, i Dijshmi”.*

Qiejt dhe toka janë krijime të çuditshme, të mëdha dhe të përpikta.

Kjo është toka në të cilën jetojmë e i shoqërojmë miliona lloje e lloje, pastaj nuk e njohim të vërtetën e saj, kurse ajo që e njohim deri më sot është shumë e paktë. Kjo tokë është një planet i vogël prej

planetëve të diellit dhe jeton nën dritën dhe energjinë e tij.

Ky diell është një prej 100,000,000 trupave qarkullues, të cilët përbëjnë botën tonë të afërt.

Në gjithësi ka edhe qarkullime tjera apo botë të tjera të ngjashme me botën tonë të afërt (galaktikën tonë), të cilat, sipas astronomëve, janë afër 100,000,000 në numër.

Ata presin që të zmadhohet ky numër pas zmadhimit të teleskopëve dhe observatoriumeve.

Mes botës sonë (galaktikës sonë) dhe botës tjetër ka përafërsisht 157,000 vjet dritë (afërsisht nëntë trilionë kilometra.)

Pastaj gjithashtu ekzistojnë mjegulla të mëdha (nebulozat), prej të cilave supozohet se janë formuar ato diellëra.

Kjo është një pjesë e vogël e njohurive tona të kufizuara!

Çdo diell prej diellërave të panumërt ka galaktikën e vet dhe shumica prej tyre ka satelitët e vetë që rrotullohen rreth tyre ashtu siç rrotullohet toka rreth diellit...

Të gjitha këto lëvizin me precizitet dhe përpikshmëri të plotë dhe në asnjë çast nuk ndalen e as nuk ngatërrohen, sepse në të kundërtën shkatërrohet

gjithësia e përgjithshme dhe ndeshen këta trupa të mëdhenj që lundrojnë në atmosferën e gjerë...

Nuk bëjmë përpjekje ta paraqesim ose ta paramendojmë këtë gjithësi të gjerë, në të cilën lundrojnë miliona e miliona trupa qiellorë, sepse një gjë e tillë e habitë mendjen!

*“A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikundër që i krijoi ata?”*

Si mund të krahasohen njerëzit me këto krijime të mëdha e të çuditshme?

*“Po, Ai është Krijuesi, i Dijshmi!”*

Zoti i Madhëruar krijon edhe këtë, edhe atë por edhe gjëra të tjera pa mundim e lodhje dhe s'ka dallim mes krijesës së madhe dhe asaj të vogël:

*“Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet”.*

Ky send bëhet qiell dhe tokë, mushkonjë dhe thnegël!

Kjo apo ajo, të gjitha janë të njëjta para fjalës: *“Bëhu!”*

Ato menjëherë bëhen!

Aty s'ka vështirësi apo lehtësi, afërsi apo largësi...

Mjafton të dëshirojë krijimin e ndonjë sendi, pa marrë parasysh se ç'është!

Zoti xh.sh. ua ofron njerëzve çështjet për t'i kuptuar me intelektin e tyre njerëzor të kufizuar.

\* \* \*


Në këtë pjesë vjen ritmi i fundit i sures, gjegjësisht ritmi që pasqyron të vërtetën e lidhjes mes ekzistencës dhe Krijuesit të ekzistencës:

*"I lartë është ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm te Ai ktheheni!"*


Termi "pushtet" në këtë formë e zmadhon dhe e madhëron të vërtetën e kësaj lidhjeje, gjegjësisht lidhjes së pushtetit absolut mbi çdo send dhe dominimit të plotë në ekzistencë.

Pastaj vetëm te Ai është kthimi!


Ky është ritmi përfundimtar që përputhet me këtë udhëtim të madh, me krejt suren dhe me temat që kanë të bëjnë me këtë të vërtetë të madhe, në të cilën shpie çdo vështrim i hollësishëm...




1. *Ja, Sinë!*
2. *Pasha Kur'anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë!*
3. *S'ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve!*
4. *Je në një rrugë të drejtë.*
5. *(Kur'ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit.*
6. *Për t'ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar.*
7. *Për Zotin tashmë ka marrë fund vendimi (thënia) kundër shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë.*
8. *Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart.*




9. *Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë e edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin.*
10. *Dhe për ata është e njëjtë, a ua tërhoqe vërejtjen a nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë.*
11. *Ti i'a tërheq vërejtjen vetëm atij që e përvetëson Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (i papashëm prej njerëzve), pra jepi myzhde atij për falje dhe shpërblim të mirë.*
12. *Vërtet, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat; gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi - Mahfudh).*
13. *Përmendju atyre një shembull të banorëve të fshatit, kur atyre u patën ardhur të dërguarit.*
14. *Kur Ne dërguam te ata dy, e ata i përgënjeshtroan që të dy, atëherë i përforcuam me një të tretë dhe u thanë: "Ne jemi të dërguar te ju".*
15. *Ata (fshatarët) thanë: "Ju nuk jeni tjetër vetëm se njerëz si ne dhe All-llahu nuk ju ka shpallur asgjë; ju nuk jeni tjetër vetëm se rrenacakë."*




16. *Ata thanë: "Zoti ynë e di se me të vërtetë ne jemi të dërguar te ju.*
17. *Dhe nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t'ju kumtojmë ashtu qartë."*
18. *Ata (fshatarët) thanë: "Ne parandajmë kob me ju dhe nëse nuk tërhiqeni, ne do t'ju gurëzojmë dhe do të përjetoni ndëshkim të idhët prej nesh."*
19. *Ata (të dërguarit) thanë: "Fati i keq është juaji, edhe pse u këshilluat (e na kërcënoheni)? Jo, por ju jeni popull i shfrenuar!"*
20. *Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri që ngutej e tha: "O populli im, dëgjoni të dërguarit!"*
21. *Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes!*
22. *E ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e te Ai kthehem.*
23. *A do të pranoj zota të tjerë pos Tij, e nëse do Mëshiruesi të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë.*
24. *Unë atëherë do të jem në një humbje të hapët.*




25. *Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni!"*
26. *Atij i është thënë: "Hyn në xhennet", e ai tha: "Ah, sikur ta dinte populli im.*
27. *për çka më fali Zoti im dhe më bëri prej të nderuarve!"*
28. *Pas tij, Ne nuk zbritëm ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tij, e as që ishte vendimi ynë të zbresim tjetër,*
29. *përveç një britme të tmerrshme, kur qe, ata të ftohur (të vdekur).*
30. *O sa dëshpërim i madh për robërit që nuk u erdhi ndonjë i dërguar, vetëm se ata u tallën me të.*
  
31. *A nuk e panë ata se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen.*
32. *Dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh.*
33. *Dhe për ata është argument (për fuqinë e Zotit) toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallëm, nxjerrim prej saj drith nga i cili ata ushqehen.*




34. *Dhe në të Ne u kemi bërë kopshte hurmash e rrushi dhe në të u kemi dhënë burime (uji).*
35. *Ashtu që ata të hanë nga ato fryte dhe nga çka prodhojnë vetë duart e tyre. A i gëzojnë këto dhe nuk falënderojnë?*
36. *I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.*
37. *Për ata është argument edhe nata, prej së cilës largojmë ditën, kurse ata mbeten në terr.*
38. *Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit.*
39. *Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut (rremb i hurmës së tharë).*
40. *As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditën, po secili noton në një gjithësi.*
41. *Argument për ta është edhe ajo se Ne pasardhësit e tyre (të Ademit) i bartëm në anije të mbushur përplot.*
42. *Dhe ngjashëm me të, u krijuam atyre diçka që t'i hipnin.*
43. *E sikur të duam Ne, i përmbysim ata, e nuk ka efekt as lutja e tyre dhe as që do të shpëtonin.*



44. Përveç nga mëshira jonë ndaj tyre dhe që të përjetojnë të mirat deri në një kohë të caktuar.
45. E kur u thuhet atyre: "Kini frikë asaj që ngjan para jush dhe asaj çka do t'ju ngjajë më vonë, e që të mëshiroheni (ata nuk dëgjojnë).
46. Nuk ka asnjë argument që u erdhi atyre nga argumentet e Zotit, e që ata nuk ia kthyen shpinën.
47. Dhe kur u thuhej: "Jepni nga ajo që All-llahu ju begatoi", ata që nuk besuan besimtarëve u thanë: "A ta ushqejmë atë që sikur të donte All-llahu do ta ushqente? Ju nuk jeni tjetër vetëm se të humbur qartë!"
48. Dhe thoshin: "Po qe se jeni të vërtetë, kur do të jetë ai premtim?"
49. (All-llahu u përgjigjet) Nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete.
50. E nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet - testament) e as të kthehen në familjet e tyre.
51. Dhe i fryhet "Surit", kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre.
52. E thonë: "Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?" E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe e vërtetuan të dërguarit.



53. *Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë të paraqitur para Nesh.*
54. *Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat.*
55. *Ata të xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi.*
56. *Ata dhe shoqet e tyre janë nën hije të mbështetur në kolltukë.*
57. *Aty ata kanë pemë dhe çka të duan.*
58. *Kanë "Selam", thënie e Zotit Mëshirues!*
59. *E tash, o ju kriminelë, ndahuni!*
60. *O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk ua dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!?*
61. *(Ju porosita) Të më adhuronit Mua, se kjo është rruga e sigurt!*
62. *Vërtetë, ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend?*
63. *Ky është xhehennemi që juve u premtuhej.*
64. *Hyni tash në të, për shkak se mohuat çdo të vërtetë!*



65. *Sot Ne ua mbyllim gojë të tyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan.*
66. *E sikur të duam Ne do t'ua verbonim sytë e tyre, e ata do ta mësynin rrugën, po si do të shihnin?*
67. *Dhe sikur të duam, do t'i kishim gjymtuar ata në vend, e nuk do të mund të shkonin as para as prapa.*
68. *E atij që i japim të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij. A nuk janë duke menduar?*
69. *Ne as nuk ia mësuam atij (Muhammedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë.*
70. *Për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë (me mend e me zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët.*
71. *A nuk e shohin ata se nga ajo që Ne vetë e shpikëm, u krijuam atyre kafshë që ata i kanë.*
72. *Dhe ua bëmë ato që t'u binden atyre, e disave prej tyre u hipin, ndërsa prej disave ushqehen.*
73. *Ata kanë edhe dobi të tjera në to, e edhe pinë (qumësht) prej tyre. A nuk duhet të falënderojnë?*



74. *Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre.*
75. *Ata nuk mund t'u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) janë bërë ushtri e gatshme e tyre.*
76. *E ty të mos brengosin thëniet e tyre, Ne dimë çka mbajnë ata fshehtë e çka publikojnë.*
77. *A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pikë uji (fare), kur qe, ai, kundërshtar i rreptë.*
78. *Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur"?*
79. *Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim."*
80. *Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni.*
81. *A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikur që i krijoi ata? Po, Ai është Krijuesi, i Dijshtëmi.*
82. *Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: "Bëhu!" Ai menjëherë bëhet.*
83. *I lartë është Ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm te Ai ktheheni.*

